


# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6858  
E shtunë, 25 mars 2023  
çmimi 0.40 €

Rama në Londër:  
Kriminelët po i përdorin  
'ëndrrat dhe shpresat'  
e shqiptarëve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHËNOHET 25-VJETORI I EPOPESË SË DUKAGJINIT | FAQE 4-5

## KURTI: PAS REZISTENCËS SË PASHEMBULLT TË JASHARËVE NË PREKAZ, VJEN QËNDRESA E FUQISHME E FAMILJES HARADINAJ



Kryeministri i vendit, Albin Kurti, me rastin e shënimit të 25-vjetorit të Epopesë së Dukagjinit, ka qëndruar të premtën në Glllogjan të Deçanit. Pas homazheve në Kompleksin

Memorial "Dëshmorët e Kombit", Kurti ka vizituar edhe familjen Haradinaj. Kryeministri ka folur edhe në akademinë përkujtimore me rastin e manifestimit të Epopesë së Dukagjinit, në të

cilën ka thënë se, pas rezistencës së pashembullt të Jasharëve në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars, vjen qëndresa e fuqishme e familjes Haradinaj dhe Mehmetaj në Glllogjan më 24 mars

PËRKUJTOHET 24-VJETORI  
I INTERVENIMIT TË NATO-S  
QË PARANDALOI  
SHFAROSJEN E POPULLIT  
TË KOSOVËS



KËSHILLI EVROPIAN:  
KOSOVA DHE SERBIA TA  
ZBATOJNË MARRËVESHJEN  
PËR NORMALIZIMIN E  
MARRËDHËNIEVE



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



BLINKENI E SIGURON KONGRESIN  
SE FONDET PËR UKRAINËN  
DO TË ZGJASIN GJITHË VITIN | F. 2

5.5 MILIONË FRANGA  
PËR PROJEKTIN 'SHËRBI ME  
SHËNDËTËSORE TË INTEGRUARA' | F. 5

ABDIXHIKU ALARMON:  
TRUSTI ÇDO DITË PO HUMB  
NGA GJYSMË MILION EURO | F. 6

### EKONOMI



KOSOVA DHE BE-ja NËNSHKRUAJNË  
MARRËVESHJEN IPA 2022  
ME VLERË 62 MILIONË EURO | F. 8

BIE KOSTOJA E NDËRTIMIT,  
JO E BANESAVE | F. 7

### SPORT



KOSOVA SYNON TA NISË  
ME KËMBË TË MBARË  
KAMPANJËN KUALIFIKUESE | F. 10

## Blinkeni siguron Kongresin se fondet për Ukrainën do të zgjasin gjithë vitin

WASHINGTON, 24 MARS - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, e ka siguruar anëtarët e Kongresit se miliarda dollarët e destinuar dhe të miratuar për ndihmë ndaj Ukrainës janë të mjaftueshme dhe se do të duhej të zgjasin për pjesën më të madhe të vitit 2023.

Kongresi miratoi një projektligj në dhjetor të vitit të kaluar, që përfshinte 45 miliardë dollarë ndihmë urgjente për Ukrainën. Blinken, duke dëshmuar më 23 mars para nënkomisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për ndarjet buxhetore, nuk tha saktësisht se kur administrata mund të kishte nevojë të kërkonte më shumë fonde, por tha se financimi i fundit "e mbulon pjesën më të madhe të këtij viti".

Seanca dëgjimore u fokusua në kërkesën buxhetore të Departamentit të Shtetit për vitin fiskal 2024, e cila është 11 për qind më shumë krahasuar me vitin aktual fiskal.

Disa ligjvënës republikanë kanë vënë në dyshim sasinë e parave të dërguara në Kiev, duke pasur parasysh deficitet buxhetore dhe biseda për shkurtime në programet e brendshme të ShBA-së. "Buxheti do ta mbështesë sigurinë tonë, mbështetjen tonë ekonomike, energjetike dhe humanitare për Ukrainën, në mënyrë që të sigurohemi që lufta e presidentit [Vladimir] Putin të mbetet një dështim strategjik", u tha Blinken anëtarëve të



komitetit.

Blinkeni i tha gjithashtu nënkomitit se ishin marrë masa për të siguruar që paratë e dërguara në Ukrainë të shpenzoheshin siç duhet. "I kam 45 persona në ambasadën tonë në Ukrainë, puna e të cilëve është t'i mbikëqyrin shpenzimet e këtyre parave", tha Blinken.

Ai adresoi shqetësimet se Shtetet e Bashkuara po mbajnë barrë të madhe.

Deri më tani Shtetet e Bashkuara kanë dhënë 32 miliardë dollarë ndihmë për siguri për Ukrainën, ndërsa vendet e tjera kanë dhënë 22 miliardë dollarë, tha Blinkeni. Uashingtoni ka dhënë rreth 15.5 miliardë dollarë mbështetje

ekonomike, ndërsa vendet e tjera kanë dërguar 24 miliardë dollarë, shtoi ai.

Ndarja e ndihmës humanitare është 2 miliardë dollarë të dërguar nga Uashingtoni dhe 3.5 miliardë dollarë të dërguar nga vendet e tjera. "Ne kemi një shpërndarje reale të barrës kur bëhet fjalë për Ukrainën", tha ai, duke vënë në dukje se vendet

evropiane kanë pranuar rreth 8 milionë refugjatë.

Blinken, gjatë dëshmisë se tij, hodhi poshtë perspektivat afatshkurtër për bisedimet për paqe në mes të Moskës dhe Kievit, duke thënë se Rusia nuk është serioze dhe se do të përdorë një armëpushim vetëm për t'i rifurnizuar dhe riarmatosur forcat e saj. Megjithatë, ai pranoi se forcat ukrainase nuk do të jenë në gjendje ta rifitojnë të gjithë territorin e tyre në fushëbetejë. "Unë mendoj se do të ketë një territor në Ukrainë për të cilin ukrainasit janë të vendosur të luftojnë në terren dhe mund të ketë territor që ata vendosin se do të duhet të përpiqen ta rikthejnë në mënyra të tjera", tha Blinken.

Ai e bëri këtë komentë në përgjigje të një pyetjeje nga përfaqësuesi Chris Stewart (republican nga Uta), i cili pyeti nëse Shtetet e Bashkuara mbështetnin qëllimin e presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky për ta rimarrë Krimenë.

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre evropianë kanë refuzuar ta njohin aneksimin e paligjshëm të Krimesë nga Moska në vitin 2014.

Blinken theksoi se vendimet për Krimenë "duhet të jenë vendime ukrainase për atë që duan të jetë e ardhmja e tyre... për sa i përket sovranitetit, integritetit territorial, pavarësisë së vendit".

## Hungaria thotë se nuk do ta arrestonte Putinin

BUDAPEST, 24 MARS - Hungaria nuk do ta arrestojë presidentin rus Vladimir Putin nëse ai do të hyjë në vend, tha shefi i kabinetit të kryeministrit Viktor Orban, duke shtuar se nuk ka asnjë bazë ligjore për t'u bërë një gjë e tillë.

Hungaria është nënshkruese dhe ratifikuese e Statutit të Romës që krijoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare (ICC), e cila lëshoi një urdhër-arrestim për presidentin e Ruisë, Vladimir Putin, duke e akuzuar atë se është përgjegjës për dëbimin e paligjshëm të fëmijëve nga Ukraina, që përbën krim lufte.

I pyetur nëse Putini do të arrestohej nëse do të shkonte në Hungari, shefi i kabinetit të Orbanit, Gergely Gulyas, tha në një konferencë se Statuti i Romës nuk ishte ndërtuar në sistemin ligjor hungarez. "Ne mund t'i referohemi ligjit hungarez dhe bazuar në këtë nuk mund ta arrestojmë presidentin rus... pasi statuti i

ICC nuk është shpallur në Hungari", tha Gulyas.

Kur u pyet, ai tha se qeveria e tij "nuk kishte formuar një qëndrim" për urdhër-arrestimin e lëshuar kundër Putinit. "Këto vendime nuk janë të duhura, pasi ato i çojnë gjërat drejt përshkallëzimit të mëtejshëm dhe jo drejt paqes. Ky është mendimi im personal", shtoi Gulyas.

Rusia e ka cilësuar "skandaloz" vendimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare ndaj Putinit.

As Rusia as Ukraina nuk janë anëtare të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Kievi, megjithatë, i ka dhënë juridiksion kësaj gjykate që t'i ndjekë krimet e kryera në territorin e saj qëkur Moska nisi pushtimin vitin e kaluar.

Gjykata Penale Ndërkombëtare, e përbërë nga 123 anëtarë, nuk ka forcë policore për t'i zbatuar urdhër-arrestet, por varet nga shtetet anëtare që t'i arrestojnë të dyshuarit për t'i sjellë më pas për



gjykim në Hagë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy ka thënë se masa e ICC-


së do të çonte në "përgjegjësi historike", duke shtuar se dëbimet e fëmijëve nga Ukraina përbënin

një politikë "të së keqes shtetërore që filloi pikërisht nga zyrtari më i lartë i këtij shteti [Ruisë]".

# Rama në Londër: Kriminelët po i përdorin 'ëndrrat dhe shpresat' e shqiptarëve

LONDËR, 24 MARS - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në Londër, ku po qëndron për vizitë, e ka lidhur emigrimin e shqiptarëve drejt Britanisë së Madhe me nevojën e tregut britanik për punëtorë. Në një bashkëbisedim në auditorin e Institutit Mbretëror të Marrëdhënieve Ndërkombëtare "Chatham House", Rama ka thënë se problemi nuk qëndron te shqiptarët që mbërrijnë në Britani, por te fakti se disa shqiptarë përdoren në "ëndrrat dhe shpresat e tyre nga kriminelët". "Ka diçka mjaft të rëndësishme që po ndodh e që e kemi kërkuar prej shumë kohësh. Gjithnjë kemi thënë se na duhet të ndërtojmë një portë të përbashkët operative për t'i goditur rrjetet kriminale. Nuk kam probleme se kufijtë e Britanisë mbyllen, por s'duhet t'i lëmë të rinjtë shqiptarë të përdoren nga kriminelët. Komuniteti shqiptaro-britanik është fantastik, ndërsa kriminelët shqiptarë nuk e sollën krimin këtui, ata nuk e sollën drogën këtu, por e gjetën këtu tregun. Nëse homologët britanikë do të na dëgjojnë, kjo do të jetë shumë e suksesshme. Por, t'i veçosh shqiptarët nuk është e drejtë", ka thënë Rama.

Në një paraqitjeje publike në nëntor të vitit që shkoi, ministrja e Brendshme e Britanisë, Suella Braverman, i ka quajtur "kriminelë" shqiptarët që mbërrinin me gomone në Britani.



Kjo deklaratë ka shkaktuar replika ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe britanike, ndërsa mijëra

emigrantë shqiptarë dolën në protesta në rrugët e Londrës, të indinjuar nga ky etiketim dhe

kërkuan që qeveria britanike të kërkonte falje. Rama tha se kontributi i

komunitetit shqiptar në Britani do të jetojë shumë më gjatë se Suella Braverman dhe kërkoi që komuniteti shqiptar të vazhdojë "të tregojë veten siç e ka treguar deri tani, duke nderuar flamurin shqiptar dhe atë britanik".

Një ditë më parë kryeministri Edi Rama u prit në Downing Street nga kryeministri i Britanisë, Rishi Sunak. Në komunikatën e zyrës së qeverisë britanike pas takimit, u theksua se "dy kryeministrit u angazhuan për thellimin e punës në kuadër të Deklaratës së Përbashkët dhe Task-Forcës, për të cilat u ra dakord në dhjetor, për ta avancuar adresimin e migracionit të paligjshëm dhe bandave kriminale të trafikimit të njerëzve".

Sipas autoriteteve britanike, rreth 800 emigrantë të paligjshëm janë kthyer në Shqipëri që prej muajit dhjetor të vitit të kaluar. Në fund të vitit 2022, të dyja vendet nënshkruan një deklaratë të përbashkët, me të cilën angazhoheshin për hapa konkretë për ta goditur emigracionin e paligjshëm.

Për bashkëpunimin në drejtësinë penale, kryeministri Edi Rama dhe kryeministri britanik, Rishi Sunak, përshëndetën punën e përbashkët për ekstradimin e qindra të burgosurve. Ata ranë dakord që një ekip i përbashkët të kryejë një vlerësim të kapaciteteve të burgjeve të Shqipërisë, një proces që pritet të përfundojë deri në fund të prillit.

## Këshilli Evropian: Kosova dhe Serbia ta zbatojnë marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve

BRUKSEL, 24 DHJETOR - Udhëheqësit e shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian mirëpritën marrëveshjen e arritur në bisedimet ndërmjet udhëheqësve të Kosovës dhe të Serbisë më 18 mars në Ohër.

Të dyja palët u pajtuan të shtunën të zbatojnë një plan të mbështetur nga perëndimi për normalizimin e marrëdhënieve që është kusht për përmirësimin e aspiratave të tyre për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Këshilli Evropian mirëpret marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe planin e zbatimit të saj, të arritur në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, si pjesë integrale e rrugës së tyre evropiane, dhe u bën thirrje të dyja palëve që të zbatojnë me shpejtësi dhe në mirëbesim detyrimet e tyre përkatëse", thuhet në tekstin e përfundimeve të Këshillit Evropian.

Plani evropian për të cilin palët u pajtuan më 27 shkurt në Bruksel,

ndërsa më 18 mars në Ohër për zbatimin e tij, kërkon marrëdhënie të mira fqinjësore, njohje të dokumenteve dhe simboleve dhe respektim të sovranitetit dhe tërësisë tokësore të njëra-tjetrës. Ai kërkon që palët të mos pengojnë njëra-tjetrën në proceset integruese, por nuk kërkon njohje të ndërsjellë.

Mosnënshkrimi i dokumentit në takimin e Ohrit nxiti mëdyshje nëse marrëveshja mund të trajtohet si ligjërishit e detyrueshme.

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara thonë se pavarësisht që kjo marrëveshje nuk u nënshkrua nga palët, ajo është detyrim ligjor që përfshinë edhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të mëparshme të arritura në bisedimet ndërmjet palëve.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se "nuk ka bisedime për anëtarësim në Kombet e Bashkuara dhe nuk ka njohje. Çdo gjë tjetër që nënkupton normalizim të vërtetë të



marrëdhënieve, pa tensione e pa konflikte, Serbia do ta zbatojë". Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, i cili raportoi në Këshillin Evropian, tha se çdo përpjekje për ta vënë në

pikëpyetje marrëveshjen, është e kotë. "Marrëveshja është arritur dhe duhet të zbatohet. Nuk ka vend për zgjedhje, duhet të zbatohet në tërësi nga të gjitha palët dhe ne do të vëzhgojmë me

kujdes se kush e zbaton dhe kush nuk e zbaton. Dhe do t'i këshilloja (Kosovën dhe Serbinë) që të mos e drejtojnë gishtin ndaj askujt, por ta kryejnë punën e tyre", ka thënë Borrelli.



SHËNOHET 25-VJETORI I EPOPESË SË DUKAGJINIT

# Kurti: Pas rezistencës së pashembullt të Jasharëve në Prekaz vjen qëndresa e fuqishme e familjes Haradinaj

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, me rastin e shënimit të 25-vjetorit të Epopesë së Dukagjinit, ka qëndruar të premtën në Glogjan të Deçanit. Pas homazheve në Kompleksin Memorial “Dëshmorët e Kombit”, Kurti ka vizituar edhe familjen Haradinaj. Kryeministri ka folur edhe në akademinë përkujtimore me rastin e manifestimit të Epopesë së Dukagjinit, në të cilën ka thënë se, pas rezistencës së pashembullt të Jasharëve në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars, vjen qëndresa e fuqishme e familjes Haradinaj dhe Mehmetaj në Glogjan më 24 mars

**EPOKA ERE**

Mal QORRAJ

DEÇAN, 24 MARS - Dje në Glogjan të Deçanit është shënuar 25-vjetori i Epopesë së Dukagjinit. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues të FSK-së, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, familje të dëshmorëve dhe qytetarë të shumtë.

Më 24 mars të vitit 1998 në Glogjan është zhvilluar beteja frontale në mes të forcave të UÇK-së dhe forcave të Serbisë të

cilat e kishin rrethuar Glogjanin. Ato synim kishin shtëpinë e familjes Haradinaj, por aty hasën në rezistencë të fuqishme. Në këtë ditë ranë dëshmorë Himë Haradinaj, Gazmend e Agron Mehmetaj.

Në këtë përvjetor të Epopesë së Dukagjinit ishte i pranishëm edhe kryeministri Albin Kurti, i cili ka mbajtur fjalim në akademinë përkujtimore. Pas homazheve në Kompleksin Memorial “Dëshmorët e Kombit” në Glogjan, Kurti ka vizituar familjen Haradinaj. Ai është pritur nga kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e

Kosovës, Ramush Haradinaj.

Kryeministri Kurti ka thënë se rezistenca e familjes Haradinaj dhe Mehmetaj tregon vendosmërinë e popullit shqiptar për lirinë. Kurti ka bërë me dije se mesazhi që është përçuar nga kulla e Glogjanit ndaj forcave serbe ishte se “nuk mposhtet kulla, nuk gjunjëzohet UÇK-ja”. “Në fillimpranverën e vitit 1998, pas rezistencës së pashembullt të Jasharëve në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars, vjen qëndresa e fuqishme e familjes Haradinaj dhe Mehmetaj në Glogjan më 24 mars. Të dyja këto e kishin

një armik - Serbinë, e kishin një qëllim - lirinë. Beteja e ashpër e 24 marsit dëshmoi guximimin dhe vendosmërinë e familjes Haradinaj dhe të popullit tonë në rrugën e nisur drejt çlirimit. Nuk gjunjëzohet kulla, nuk mposhtet UÇK-ja, nuk mposhtet Kosova. Ky ishte mesazhi që Serbia fashiste e mori nga kulla e bacës Hilmi”, ka thënë Kurti.

Kreu i qeverisë ka kujtuar pozicionet që kishin marrë ushtarët asokohe në mbrojtje të vendit. “Të vendosur në katër pozicione: Hilmi Haradinaj së bashku me Mejremen dhe Frashrin, Ramush Haradinaj së bashku me Bujarin, Dauti me Rasimin e Kujtimin dhe Shkëlzeni me Enverin, mbajtën në këmbë kullën, mbajtën në këmbë popullin. Në po atë ditë ranë dëshmorë: Gazmend Mehmetaj, Himë Haradinaj dhe Agron Mehmetaj, sakrificën e të cilëve sot e nderojmë dhe kujtojmë me respektin më të

lartë”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se familja Haradinaj ua di mirë vlerën lirisë e ushtrisë, teksa ka shtuar se është familje e dëshmorëve të kombit me gjeneralë nga lufta. “Familja Haradinaj ua di mirë vlerën lirisë dhe ushtrisë. Është familje e dëshmorëve të kombit me gjeneralë nga lufta. Ushtria është pjesë e pandashme e kësaj familjeje. Sot në ushtrinë tonë e kemi Luanin, toger Luan Haradinaj, i cili me zell e përkushtim i shërben atdheut në uniformën e FSK-së. Fokusi ynë kryesor si qeveri ka qenë dhe është investimi në ushtri, në mbrojtjen fisnike të vendit tonë. Duke kujtuar UÇK-në, duke zhvilluar FSK-në, mbrojmë Republikën, përparojmë kombin, i kontribuojmë Evropës”, ka thënë kryeministri Kurti. Kurti ka treguar se fokusi kryesor i qeverisë ka qenë dhe është investimi në ushtri, në mbrojtjen fisnike të vendit tonë



dhe se, “duke kujtuar UÇK-në, duke zhvilluar FSK-në, mbrojmë Republikën, përparojmë kombin, i kontribuojmë Evropës”. Ish-komandanti i UÇK-së në Zonën e Dukagjinit, Ramush Haradinaj, në shënimin e 25-vjetorit të Epopesë së Dukagjinit, ka thënë se Serbia ka synuar që mos ta lë askënd të gjallë. Duke folur para të pranishmëve, Haradinaj ka thënë se Serbia është thyer në Glogjan. Ai ka thënë se në luftën e Kosovës askush nuk

është ndarë me zona, por të gjithë kanë qenë të bashkuar. Haradinaj ka thënë se ndihmë të madhe fitores i kanë dhënë edhe bombardimet e NATO-s një vit më vonë. “Ne e njohim këtë ditë si ditën e fitores. E vërtetë se ata kanë qenë luftëtarë të hershëm. Këta të tre atë ditë u flijuan me një betejë që mori kuptim. Kuptimi i saj është fitorja. Serbia kishte ndjekur një strategji të vetën, kishte goditur në Qirez e Prekaz. Ishte porosia që të mos lini askënd gjallë. Zoti deshi që ata

të tërhiqen me turp e ne me fitore. Miti i Serbisë u thye këtu. Pse kjo ditë e jona është e fitores? Sepse nuk ndamë askënd nga lufta”, është shprehur Haradinaj, duke shtuar se atë ditë erdhën sulmet e NATO-s të prira nga Amerika. “Unë me zemër iu them Amerikës dhe NATO-s që çdo ditë keni qenë me ne. Ne si Kosovë do të rreshtohemi me NATO-n, Amerikën dhe besoj shumë se Kosova e ka vendin në NATO, që të punojë për lirinë”, u shpreh Haradinaj.

Ndërsa kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se 24 marsi është dita që e bën krenar tërë kombin shqiptar. Ai ka kujtuar edhe dëshmorët e rënë në këtë ditë, Himë Haradinaj, Gazmend e Agron Mehmetaj. “24 marsi është dita që e bën krenar tërë kombin shqiptar. Atë ditë kremtuam fitoren dhe triumfuan ndaj pushtuesit. Tash e 25 vjet më parë, me skenarin e njëjtë, si të familjes Jashari, forcat serbe sulmuan familjen Haradinaj. Nga kjo ditë nuk

## 5.5 milionë franga për projektin “Shërbime Shëndetësore të Integruara”

PRISHTINË, 24 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, kanë nënshkruar marrëveshje për projektin “Shërbime Shëndetësore të Integruara” në vlerë 5.5 milionë CHF. Ky projekt në fokus ka sëmundjet jontjetëse dhe u del në ndihmë posaçërisht grupeve të cënueshme që përgjithësisht kanë status shëndetësor më të dobët, përballen me situata më të vështira ekonomike, kanë rrezik më të shtuar të përjashtimit social në krahasim me popullsinë e përgjithshme.



mbebi asnjë fshat pa iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në krye me gjeneralin Ramush Haradinaj”, ka thënë Ramosaj. Në një deklaratë për medie presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Epopeja e Dukagjinit është një nga ngjarjet më heroike të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për lirinë e vendit.

# Përkujtohet 24-vjetori i intervenimit të NATO-s që parandaloi shfarosjen e popullit të Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, bashkë me ambasadorë të shteteve të Quint-it, kanë bërë homazhe te memoriali i ushtarëve të rënë të NATO-s për lirinë e Kosovës, në 24-vjetorin e fillimit të intervenimit të NATO-s, me të cilin iu dha fundi gjenocidit të regjimit gjenocidal të Serbisë ndaj qytetarëve të Kosovës. Presidentja Osmani ka theksuar se vullneti i popullit të Kosovës për liri mori mbështetjen e duhur nga ana e botës perëndimore, botës së lirë, e cila u vu në anën e duhur të historisë, në anën e së drejtës. “Miku i madh i Kosovës, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton, në ditën e dhënies së urdhrimit për fillimin e bombardimeve, në një fjalim historik të tij, deklaroi: ‘Forca jonë ushtarake iu bashkua aleatëve tanë të NATO-s në sulmet ajrore kundër forcave serbe, përgjegjëse për brutalitetin kundër Kosovës’,”

është shprehur Osmani.

Më tej, Osmani ka theksuar se NATO-ja ia pamundësoi regjimit kriminal spastrimin etnik të popullit të Kosovës. “Prandaj u jemi përherë mirënjohës. 24 marsi është dita e kthesës, shpresës dhe lirisë. Do ta përsërisim çdoherë se populli i Kosovës ishte viktimë më 1999, ndërkaq Serbia ishte agresore. Kështu do të jetë gjithnjë në analet e historisë”, është shprehur Osmani. Sipas presidentes Osmani, liria është një gur themeltar i dinjitetit njerëzor. “Megjithatë, këto vlera nuk janë gjithmonë të lehta për t’u ruajtur. Po jetojmë në një kohë kërcënimesh për të gjithë ne. Prandaj, sërish botës së lirë i duhet unitet kundrejt tiranëve, autokratëve e diktatorëve. Ne duhet të dëshmojmë se paqja dhe liria nuk janë ideale të dëshiruara, por realitete të jetuara. Ne e çmojmë kontributin e miqve tanë, ndaj duke ruajtur aleancën me partnerët tanë, do ta ruajmë lirinë dhe të ardhmen tonë”, ka deklaruar



ajo.

Presidentja Osmani ka falënderuar gra e burra të shteteve anëtare të NATO-s për kontributin e tyre më 1999 për lirinë e Kosovës dhe ka potencuar se secili nga ta gëzon mirënjohjen e thellë e të vazhdueshme të popullit të Kosovës. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se nën komandën e gjeneralit Wesley Clark, fushata bombarduese 78 ditore e Aleancës Veriatlantike në krye me ShBA-në i dha fund spastrimit etnik dhe gjenocidit të Serbisë mbi shqiptarët në Kosovë. “E nga qielli i përflakur shkëlqeu liria. 24 vjet më pas, Republika e Kosovës, e ndërtaur mbi themelet e

luftës çlirimtare të UÇK-së, martirizimit të popullit tonë dhe ndihmës ushtarake të NATO-s, është shtet demokratik, sovran dhe i pavarur. Shembulli më i mirë në Ballkan, Evropë e më gjerë për jetën e lirë të qytetarëve të barabartë, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve pakicë”, ka shkruar Konjufca në “Facebook”. Po ashtu, Konjufca ka theksuar se gjatë këtyre viteve të pasluftës Republika e Kosovës ka shënuar përparime të dukshme në të gjitha fushat dhe përbën sot një faktor paqeje, bashkëpunimi e stabiliteti në rajon. “Jemi të vendosur që, me mbështetjen e miqve dhe aleatëve tanë të përhershëm, të avancojmë në proceset integruese dhe të mbrojmë me çdo kusht pavarësinë, sovranitetin, integritetin territorial dhe rendin kushtetues në çdo pjesë të shtetit tonë. Populli ynë do t’u jetë përjetë mirënjohës shteteve anëtare të Aleancës së NATO-s dhe misionit ushtarak KFOR për gjithë çfarë kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë

për lirinë, paqen, stabilitetin dhe sigurinë e Republikës së Kosovës”, ka theksuar Konjufca. 24-vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe në Kosovë dhe Serbi, të cilat për 78 ditë gjunjzuan kasapin e Ballkanit, Sllobodan Millosheviq dhe aparatit e tij kriminal, e ka kujtuar edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. Ai ka thënë se kjo ndërhyrje, e cila erdhi si rrjedhojë e përpjekjeve, kërkesës dhe rezistencës së popullit tonë për liri, përfshirë luftën e drejtë dhe të guximshme të UÇK-së, i dha fund një regjimi gjenocidal duke hapur epokën e ëndërruar të lirisë për ne. “Ky kapitull, kjo shpresë e re, ndihmoi çlirimin, pavarësinë dhe krijimin e shtetit tonë. Prandaj, u jemi përjetësisht mirënjohës aleatëve tanë ndërkombëtarë, shteteve anëtare të NATO-s, të cilat 24 vjet më parë realizuan këtë mision fisnik dhe humanitar. Faleminderit - dje, sot, nesër, përgjithmonë!”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

## Ekipet e xhenios së FSK-së ndihmojnë qytetarët e prekur nga vërshimet

PRISHTINË, 24 MARS - Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes ushtarake për autoritetet civile, ekipet e xhenios së Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me autoritetet e komunës së Skenderajt, kanë filluar

montimin e urës mobile ushtarake "Mabey Johnson" në fshatin Aqarevë, e cila në vërshimet e fundit ishte dëmtuar dhe ishte bërë e pakalueshme.

Ura që do të vendoset për ta lehtësuar qarkullimin e qytetarëve ka gjetësinë 27


metra dhe pritet të përfundojë brenda dhjetë ditëve.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka njoftuar se me kapacitetet e saj është e gatshme dhe e përgatitur t'u ofrojë ndihmë qytetarëve për ta lehtësuar jetën e tyre në rrethanat kur ata gjenden në vështirësi.



# USAID-i dhe SDC ndërtojnë partneritet për ta çuar përpara barazinë gjinore në vendimmarrje dhe procese politike në Kosovë

PRISHTINË, 24 MARS - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëfinancimi për ta mbështetur më tej gjithëpërfshirjen dhe angazhimin politik të grave në nivel komunal. Përmes kësaj marrëveshjeje, qeveria zvicerane do t'i kontribuojë me 5 milionë dollarë amerikanë aktivitetit aktual të USAID-it Përfaqësimi Gjithëpërfshirës dhe Llogaridhënës, të vlefshëm 10 milionë dollarë, i cili zbatohet nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI). USAID-i po udhëheq, në nivel global, përpjekjet për të



identifikuar dhe ndjekur mënyra të guximshme dhe inovatore të ndihmës për adresimin e sfidave dhe pengesave ndaj pjesëmarrjes

së grave në vendimmarrje dhe procese politike. Përmes këtij partneriteti me SDC-në në Kosovë, USAID-i do të punojë për

avancimin e shkathtësive dhe ndërtimin e kapaciteteve të grave aktive në politikë dhe atyre që janë të interesuara t'i

bashkëngjiten skenës politike goftë si anëtare të partive politike, kandidate apo përfaqësuese të zgjedhura.

Aktiviteti Përfaqësimi Gjithëpërfshirës dhe Llogaridhënës i USAID-it në Kosovë është një partneritet pesëvjeçar i cili do ta avancojë më tej përgjegjshmërinë legislative dhe politike duke punuar rreth tri shtyllave kryesore: ndikimit individual, reformave strukturore dhe ndryshimeve shoqërore, për t'i pozicionuar gratë në mënyrë më efektive që ato të mund të garojnë politikisht me burrat nën kushte të barabarta.

Që nga viti 1999 USAID-i ka investuar në emër të popullit amerikan mbi 1 miliard dollarë amerikanë në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës.

## Abdixhiku alarmon: Trusti çdo ditë po humb nga gjysmë milioni euro

Prishtinë, 24 mars - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se Trusti çdo ditë është duke humbur nga gjysmë milioni euro, ndërkohë që qeveria ende s'ka marrë ndonjë veprim për ta caktuar bordin drejtues të kompanisë për kursimet pensionale. Abdixhiku ka thënë se që nga muaji janar e deri më sot për 36

milionë euro ka ndodhur zhvlerësim i fondeve të Trustit. "Përderisa kursimet pensionale, të fituara me shumë mund, humbasin vlerë nga gjysmë milioni euro në ditë, popullistët vazhdojnë rehatinë. Plot 36 milionë euro është zhvlerësimi i fondeve nga janari deri më sot. Qeveria nuk gjen as bregën e as kohën të caktojë një bord", ka shkruar Abdixhiku.



## 35 zyrtarë të MASHTI-t certifikohen në trajnimin për prokurim publik

PRISHTINË, 24 MARS - Ministrija e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka marrë pjesë në certifikimin e 35 zyrtarëve të MASHTI-t në trajnimin për prokurim publik. "U certifikuan sot 35 zyrtarë të MASHTI-t pasi

vijuan trajnimin për prokurim publik në kuadër të Projektit të Qeverisë Britanike 'Kosovo Strengthening Public Procurement Project', në bashkëpunim me DAI. Ky trajnim fokusohet në bashkëpunimin e departamenteve të Ministrisë

me Departamentin e Prokurimit si dhe përgatitjen e specifikave teknike. I përgëzojmë zyrtarët tanë për përfundimin me sukses të këtij trajnimi si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të tyre", ka thënë Nagavci.



## Bie kostoja e ndërtimit, jo edhe e banesave

Për një banesë të re në Prishtinë, varësisht lokacionit, blerësi duhet të paguajë nga 900 euro deri në mbi 2 500 euro për metër katror. Nga Shoqata e Ndërtimtarëve të Kosovës thonë se çmimet janë të ngjashme edhe në Prizren, rreth 85 kilometra larg kryeqytetit, ndërsa pak më të ulëta janë në Fushë-Kosovë, Ferizaj, Gjilan dhe Pejë

**PRISHTINË, 24 MARS** - Kostoja e ndërtimit në Kosovë, pas më shumë se një viti rritjeje të vazhdueshme, ka rënë. Megjithatë, kjo nuk ka bërë që të bien edhe çmimet e patundshmërive.

Për një banesë të re në Prishtinë, varësisht lokacionit, blerësi duhet të paguajë nga 900 euro deri në mbi 2 500 euro për metër katror. Nga Shoqata e Ndërtimtarëve të Kosovës thonë se çmimet janë të ngjashme edhe në Prizren, rreth 85 kilometra larg kryeqytetit, ndërsa pak më të ulëta janë në Fushë-Kosovë, Ferizaj, Gjilan dhe Pejë.

Inflacioni, si gjetiu në botë, ka nisur të rritet në vitin 2021 si pasojë e çregullimeve në tregje që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit, ndërsa ka

vazhduar edhe gjatë 2022-shit pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkurt të atij viti. Shtrenjtimi i materialit ndërtimor ka shtrenjtuar më pas edhe banesat mbi 20 për qind. Për krahasim, një metër katror i një banese në Fushë-Kosovë - gjashtë kilometra larg Prishtinës - ka arritur në 650 euro e më shumë në mars të vitit 2022, nga 500 sa ka qenë vitin paraprak. Çmimi atje vazhdon të jetë i njëjtë, sipas Shoqatës së Ndërtimtarëve.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se mesatarja e kostonë së ndërtimit në vitin 2021 dhe 2022 ka shënuar rritje deri në 16 për qind krahasuar me vitin 2020.

Por, në tremujorin e fundit të vitit të kaluar kostoja e ndërtimit ka

rënë për 0.6 për qind, tregojnë të dhënat e ASK-së të publikuara këtë muaj. “Çmimi i banesave të reja vështirë se mund të shënojë rënie. Nuk ka pasur rënie [aq të madhe] të kostonë së ndërtimit”, thotë kryetari i Shoqatës së Ndërtimtarëve të Kosovës, Faton Hoxha, për “Radion Evropa e Lirë”. “Pothuajse të gjitha shpenzimet dhe materialet ndërtimore kanë çmime të njëjta. Një rënie të vogël të çmimit kanë pasur çimentoja dhe hekuri”, thotë ai.

Në një deklaratë për “REL”-in në mars të vitit të kaluar, Hoxha ka thënë se çmimi i hekurit është rritur për 40 % krahasuar me një vit më herët, ndërsa i çimentos për 80 %. Të dyja këto produkte, sipas tij, kanë pasur rënie të lehtë në fund të vitit të kaluar - çimentoja për 5 % dhe hekuri për 10 % por që, sipas tij, vazhdojnë të jenë çmime të larta krahasuar me vitin 2020.

Meriton Cana, nga një agjenci patundshmërisht në Prishtinë, thotë se nuk pret që çmimet e banesave të reja të bien këtë vit marrë parasysh faktin se ato janë ndërtuar me material më të shtrenjtë. “Në patundshmëri janë dy çmime - ai ofertues dhe i

shitjes. Në tre muajt e parë të këtij viti kemi vërejtur se çmimet ofertuese nuk kanë rënë, por negociimi në çmim ka nisur të bëhet më i madh sesa më herët”, thotë ai.

Një faktor tjetër që mban lart çmimin e banesave është çmimi më i lartë i tokave.

Sipas uebfaqeve të disa agjencive të patundshmërive, 4 ari tokë në një lagje të Prishtinës shiten deri në 140 mijë euro.

Agjentë të shitjes së patundshmërive thonë për “Radion Evropa e Lirë” se çmimet e tokave në Prishtinë janë rritur për 30 për qind e më lart krahasuar me vitin 2020.

Brahim Selimaj, pronar i një kompanie ndërtimesh në Kosovë, thotë se gjatë tre muajve të parë të këtij viti kërkesat për blerje të patundshmërive kanë rënë. “Interesimi i blerjes së banesave është shumë i vogël, sepse diaspora ka një rënie të madhe të interesimit për të blerë banesa. Deri në 70 për qind e blerësve në Kosovë kanë qenë nga diaspora”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Selimaj nuk ofron ndonjë përqindje të rënies së shitjeve, por thotë se nëse ky trend vazhdon,

sektori i ndërtimit do të bllokohet. Edhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK), në një raport të publikuar në muajin gusht të vitit të kaluar, ka parashikuar se sektori i ndërtimit dhe i patundshmërive do të përballen me probleme financiare për shkak të rritjes së kostove të produkteve dhe lëvizjes së çmimeve. Sipas raportit, përkeqësimi i situatës do të bëhet më evident për shkak të “pasigurisë në sjelljen e diasporës kosovare”.

Diaspora e Kosovës, sipas BQK-së, zë vendin e parë sa iu përket investimeve të huaja që bëhen kryesisht në patundshmëri. Nga mbi 600 milionë euro investime të huaja, sa janë bërë në periudhën janar-tetor 2022, mbi 400 milionë euro kanë shkuar në sektorin e patundshmërisë.

Gubernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka paralajmëruar në një intervistë dhënë “Radion Evropa e Lirë” në janar, se inflacioni do të bjerë në pjesën e dytë të këtij viti.

Çmimet e naftës dhe benzinës, që kanë arritur kulmin në gusht, kanë rënë. Se si do të vazhdojë trendi për produktet dhe shërbimet e tjera, mbetet të shihet.



## Prokuroria Speciale shenjëstron një rast të ri të koduar “Frangu”, tre persona janë në paraburgim

**PRISHTINË, 24 MARS** - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka mbajtur të premtën takimin e radhës me ekipin e përbashkët për përzgjedhjen dhe shenjëstrimin e krimeve të rënda, ku ka shenjëstruar një rast të ri të koduar “Frangu”, në të cilin janë të përfshirë katër persona.

Prokuroria Speciale ka njoftuar

se rasti është shenjëstruar për veprat penale “Shpëlarje e parasë”, “Fajdeja”, “Detyrimi” dhe “Pengim i të privuarit apo procedurës zyrtare”.

Ndërkaq sa iu përket hetimeve financiare, rasti është hetuar paralelisht dhe ditën e operacionit është arritur të ngrihen llogaritë bankare të të dyshuarve dhe familjarëve të ngushtë. “Në llogaritë e tyre rrjedhëse dhe të afatizuara

janë ngrirë gjithsej: 2,131,223.31 euro dhe 878,632.47 CHF”, ka njoftuar Prokuroria Speciale.

Kurse në vazhdimësi të hetimeve janë identifikuar edhe prona dhe patundshmëri të cilat me urdhër të gjykatës janë ngrirë gjashtëmbëdhjetë parcela. Në këtë rast janë të përfshirë katër persona, tre prej tyre janë në paraburgim.



# Kosova dhe BE-ja nënshkruajnë marrëveshjen IPA 2022 me vlerë 62 milionë euro

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, dhe shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, kanë nënshkruar të premtën marrëveshjen financiare IPA 2022, nga e cila Kosova përfiton 62 milionë euro për projekte në fusha të ndryshme

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 24 MARS** - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, i dorëzoi të premtën zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi marrëveshjen vjetore të financimit të 16 me radhë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës në kuadër të Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) të BE-së.

Marrëveshja me vlerë 62 milionë euro është pjesë e IPA III, që mbulon periudhën 2021-2027.

Me këtë, shumica e përgjithshme e ndihmës së drejtpërdrejtë financiare e BE-së arrin në më shumë se 1.3 miliard euro dhe rikonfirmon BE-në dhe shtetet anëtare të saj si ofruesit më të mëdha të ndihmës financiare për Kosovën. Kjo është marrëveshja e dytë e ndihmës financiare ndërmjet BE-së dhe Kosovës këtë vit. Vetëm muajin e kaluar BE-ja i dhuroi Kosovës 75 milionë euro në kuadër të Pakos për Mbështetje Energjetike për Ballkanin Perëndimor me qëllim që t'i ndihmojë qytetarët dhe bizneset të përballen me çmimet e rritura të energjisë, ta stimulojë kursimin e energjisë dhe ta përmirësojë eficiencën e energjisë. "Financimi përmes Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit është një

mjet i rëndësishëm i BE-së që ndihmon Kosovën ta zhvillojë ekonominë e saj dhe të krijojë vende të reja pune si dhe t'i harmonizojë ligjet dhe standardet e saj me ato të BE-së, të gjitha këto me qëllim për ta ndihmuar Kosovën të përparojë në rrugën e saj të integritimit në BE", ka theksuar ambasadori Szunyog, duke shtuar se financimi IPA është dëshmi e qartë dhe e prekshme se BE-ja dëshiron që Kosova t'i përmbushë të gjitha standardet e nevojshme për t'u anëtarësuar në BE. "Përdorimi i financimit të IPA-së është planifikuar me Qeverinë e Kosovës dhe synon fushat prioritare nga sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe arsimit, deri te zhvillimi i infrastrukturës, mbrojtja e mjedisit, tranzicioni i energjisë së gjelbër dhe lidhjet rrugore, hekurudhore dhe të TI-së", ka thënë ai.

Marrëveshja e financimit e nënshkruar nga zëvendëskryeministri Bislimi do ta ndihmojë Kosovën ta përmirësojë integritimin socio-ekonomik të komuniteteve joshumicë dhe të të kthyerve, ta zhvillojë infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave të zeza, duke përfshirë sistemin e kanalizimit në kryeqytet, ta përmirësojë eficiencën e energjisë në sektorin publik dhe t'i përafrojë ligjet e Kosovës me acquis të BE-së



dhe t'i mbështesë profesionistët ligjorë. "Përveç fondeve të siguruar nga BE-ja, projektet do të bashkëfinancohen nga buxheti ynë në shumën prej 4.7 milionë eurosh dhe me financim nga partnerët e tjerë dypalësh në vlerë prej 24.88 milionë eurosh. Pra, realizimi i mjeteve do të arrijë në gjithsej 91.83 milionë", ka thënë zëvendëskryeministri Bislimi. Ai ka theksuar se është kënaqësi që për një kohë kaq të shkurtër të lidhim tri


marrëveshje për programet IPA. "Pothuajse gjysma e fondeve të dedikuara nga IPA III tashmë janë zotuar për Kosovën. Ky është edhe një tregues i besimit të partnerëve dhe aleatëve tanë ndërkombëtarë se Kosova ka kapacitet për t'i zbatuar me sukses këto projekte", është shprehur Bislimi.

BE-ja ka filluar ofrimin e financimit IPA për Kosovën që në vitin 2007. Programet IPA I dhe IPA II kanë mbuluar periudhën 2007-2020, duke

përfshirë 14 marrëveshje vjetore të financimit me vlerë prej 1.2 miliardë eurosh.

Financimi IPA III, që mbulon periudhën 2021-2027 dhe marrëveshjet vjetore të financimit, kanë filluar të zbatohen vitin e kaluar, me marrëveshjen për vitin 2021 me vlerë 64 milionë euro për vitin 2022, të dorëzuar sot, me vlerë 62 milionë euro. "Shpresoj që Kuvendi i Kosovës ta ratifikojë shpejt marrëveshjen e financimit", ka thënë ambasadori Szunyog.

## Marrëveshja e Ohrit, Oda Amerikane: Hap mundësitë e zhvillimit ekonomik për të dy shtetet



**PRISHTINË, 24 MARS** - Oda Ekonomike Amerikane ka përhëndetur marrëveshjen e arritur së fundmi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve.

Oda Amerikane beson fuqishëm se marrëveshja do t'i hapë mundësitë e zhvillimit ekonomik për të dy shtetet, duke përmirësuar shkëmbimin e mallrave dhe të shërbimeve. Derisa të dyja shtetet konfirmojnë obligimin e tyre për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të shkuara, Oda Amerikane përsërit thirrjen e saj për Qeverinë e Kosovës që t'i

bashkohet iniciativës së Shqipërisë, Maqedonisë Veriore dhe Serbisë për treg të përbashkët rajonal, sipas pajtimit të bërë në Uashington më 4 shtator 2020.

Oda Amerikane, gjithashtu, u bënë thirrje të dyja shteteve që t'i respektojnë zotimet e dhëna më parë për investime në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore. "Zhvillimi i infrastrukturës së transportit, së bashku me njohjen reciproke të diplomave universitare dhe certifikimeve profesionale, do të mundësojnë lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe të mallrave, si dhe lirinë e ofrimit të

shërbimeve, duke përmirësuar në këtë mënyrë mobilitetin e bizneseve dhe profesionistëve brenda hapësirës së Ballkanit të Hapur. Në fund, duke kuptuar rëndësinë që marrëveshja do të ketë për Kosovën, Serbinë dhe rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë do t'i përkrahë përpjekjet e mëtejme për normalizim ekonomik, duke avokuar pranë qeverive për heqjen e barrierave ekzistuese, si dhe do të ofrojë mundësi rrjetëzimi për bizneset në tërë rajonin", thuhet në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.



AJAZ EMINI - Ditar (II)

# NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

## MBRESAT NGA DY VIZITAT E PARA NË VENDLINDJE

- Pas 5 viteve qëndrimi në SHBA, tani mu dha e drejta për aplikim që t'i nënshtrohem provimit të nënshtetësisë. Menjëherë pas skadimit të kohës pesë vjeçare, kërkova që të aplikoj për provimin e nënshtetësisë. Disa muaj më vonë mora thirrjen për caktimin e ditës së provimit. Pas caktimit të ditës së provimit iu përkushtova mësimi të testit dhe në ditën e caktuar shkova edhe e dhash provimin e nënshtetësisë me shumë sukses! Pas kalimit të testit të nënshtetësisë amerikane, disa muaj më vonë u caktua edhe dita e ceremonisë së përbetimit të nënshtetësisë para gjykatësit federal. Dita e ceremonisë së nënshtetësisë në Amerikë zakonisht caktohet për ndonjë festë, me qëllim që ajo ditë të bëhet sa më madhështore! Ceremonia e nënshtetësisë time u caktua për 4 Korrik 1985, në ditën e Pavarësisë së Amerikës. Në këtë ceremoni ishim mbi 50 nënshtetas të rinj, nga kontinente dhe shtete të ndryshme të botës, të gjinive, ngjyrës dhe moshave të ndryshme që po përbehohehim para himnit dhe flamurit amerikan, edhe atë nën prezencën e gjykatësit i dhe senatorit Howard Metzenbaum të Ohio, të cilët pas ceremonisë na uruan mirëseardhje dhe nënshtetësinë e re të shtetit amerikan! E gjithë ceremonia ishte organizuar në mënyrën më madhështore, me shumë flamuj amerikan, si dhe me një tortë të madhe që kishte të vizatuar flamurin dhe me shumë ëmbëlsira të tjera për të gjithë të pranishmit! Në këtë sallë të madhe të qytetit përveçse neve nënshtetasëve të rinj, kishte edhe shumë familjarë dhe pjestarë të tjerë të qytetit të Cleveland'it që ishin që të gjithë të veshur në mënyrën më solemne që ishte e mundur, e që kishin ardhë për këtë ditë ndoshta edhe më madhështoren e jetës tonë!

Pas himnit të shtetit amerikan dhe përbetimit nga gjykatësi, secilit prej nesh veç e veç na lexohej emri, dhe pastaj dilnim para të pranishmëve ku na jepej Çertifikata e re e nënshtetësisë amerikane si dhe na urohej secilit nënshtetësia nga gjykatësi dhe senatori Metzenbaum si dhe zyrtarët e tjerë të qytetit që ishin të renditur para publikut. Menjëherë pasi mora çertifikatën e nënshtetësisë amerikane, aplikova edhe për pasaportën amerikane të cilën mezi po prisja që ta merrja, sepse ajo ishte i vetmi dokument që do të më sigurojë udhëtim të lirë dhe të sigurtë për në të gjitha shtetet e botës! Pas aplikimit të pasaportës, disa muaj më vonë nëpërmjet të postës më erdhi edhe pasaporta e parë amerikane në emrin tim personal. Me këtë dokument të ri të udhëtimit tani më jepej edhe e drejta e udhëtimit anë e mbanë botës, dhe pa kurrëfarë telashesh, por qëllimi im kryesorë me këtë



pasaportë ishte vizita ime e parë në familjen dhe vendlindjen time të dashur, që për aq shumë kohë po e ëndërroja! Menjëherë pas marrjes së pasaportës amerikane vendosa që udhëtimin tim të parë jashta shtetit amerikan që do realizoja, do të jetë kthimi im në vendlindje. Kjo do të ishte vizita ime e parë pas 6 viteve, ku do të vizitoja më të dashurit e jetës sime: nënën, vëllain, motrën, kusherinjtë apo të afërmit e mi tjerë. Do të vizitoja shokët si dhe fshatin tim të dashur Llojanin të cilin e kisha parë në ëndërr shumë herë, si dhe që të gjithë bashkëfshatarët për të cilët aq shumë më kishte marrë malli! Në korrik të vitit 1986, për herë të parë pas të tëra këtyre viteve e mora rrugën për në vendlindje për të cilën aq shumë isha përmalluar, edhe pse e dija se çka mundtë të më ndodhte nga pushteti i egër jugosllav, të cilët veçse më kishin kërkuar disa herë.

Udhëtimi ishte më i lehtë pasi se kisha fluturimin direkt Klivlend-Beograd-Shkup, edhe atë me aerotransportin JAT-in jugosllav. Pas të gjithë këtijë udhëtimi, më në fundë, të nesërmen dikur vonë në mbrëmje arrita në Llojanin tim të dashur, vendlindjen që ku me e ditë se sa herë e kisha ëndërruar gjatë këtyre gjashtë viteve. Edhe pse i lindur dhe rritur aty, tani me ligjet jugosllave unë isha i obliguar që në të arritur mbrenda 24 orëshit të parë e më së voni deri në ditën e nesërme, të paraqitesha në stacionin policor të Kumanovës. Aty duhej të shkojë për t'u regjistruar për leje qëndrim në shtëpinë time, por si nënshtetas i huaj, sepse ashtu e donte ligji i tyre! Paraqitjen time e bëra sipas ligjit në sportelin e organeve të stacionit policor të Kumanovës. Kujdestari policor ma kërkoi pasaportën time amerikane për ta regjistruar në dosjet e tyre të posa ardhurin me nënshtetësi të huaj, dhe më urdhëroi që të presë për disa minuta. Pas disa minutash përsëri doli te dera edhe më tha që ta shoqëroja atë deri lartë në katin e dytë të stacionit policor, edhe atë në zyrën e një inspektori policor

shqiptar i quajtur Remzi Salu. Në fillim kisha një dyshim, por përsëri mendova ndoshta është më mirë dhe më lehtë për mua që të kuptohem me një shqiptarë të stacionit policor.

Në të hyrë në zyrën e inspektorit policor shqiptar, menjëherë pashë në fytyrën e tij një lloj arrogancë që më bëri të dyshoja se punët nuk do të shkojnë siç i kisha menduar unë. Në takimin e parë me të, me sjelljet e këtij inspektori policor, pra të Remzi Saliut nuk isha aspak i kënaqur sepse ishte një person shumë arrogant dhe menjëherë që nga fillimi filloi që të më iritojë tejmas. Meqenëse tani kisha nënshtetësinë amerikane disi nuk më frikësonte sjellja e këtij kodoshi shqipfolës, po urrejta ndaj këtyre lloj njerëzish më ishte e madhe sepse më herët më kishin dënuar shokun-djalin e dajës me burg pa kurrëfarë faji. Nuk kisha kurrëfarë respekti për këto lloj zyrtarësh shtetërorë jugosllav. Nga ana tjetër po vija nga një shtet ku liria e fjalës respektohet tejmas, tani një kohë atje kisha shijuar dhe përjetuar lirinë e vërtetë të demokracisë njerëzore në shtetin më demokrat të botës, pra në Amerikë! Pas një orë interviste dhe qëndrimi nën kërcënimet e këtij lloj inspektori shqipfolës, më thotë tani je i lire, por me kusht që të shkoj në shtëpi e të mendohem mirë, që ta rifreskoj trurin dhe të nesërmen që të kthehem po në të njejtin vend, në të njejtën zyrë dhe po në të njejtën kohë. Kërkoj pra fiks në orën 9:00 të mëngjesit, pasi se nuk kishte qenë i kënaqur nga përgjigjet e mia që ia dhash!

Pyetjet e tij ishin më tepër kërcënuese, dhe në anën tjetër po mendohej që të më angazhojë edhe mua në punën e tyre të fëlliqur, që edhe unë të filloj që të spiunoj për bashkëkombasit e mi, për shokët e mi këtu në Amerikë. I tillë të bëhem unë?! Asnjëherë! Gjatë tërë jetës sime i kisha urryjtë këto lloje njerëzish! Përgjigjet e mia në pyetjet e inspektor Remziut ishin shkurt e shqip, me një rresht të tërë dhe të qartë "Për këta njerëz që po



interesohesh ti nuk i njoh, dhe sa për të tjerë shqiptarë përveçse punëve të tyre personale edhe mbajtjes së familjeve të tyre ata nuk çajnë kokën për asgjë tjetër, e lere më politikën tuaj jugosllave"! Në fillim u mora në pyetje për rreth shoqërisë time që kisha në Amerikë, për aktivitetet e mia, si dhe me çka po mirresha, për shoqatat shqiptare në Amerikë si dhe për shkrimet anti-jugosllave në shtypin e ndryshëm shqiptarë dhe atë amerikan.

Mirëpo me kalimin e kohës, më vonë e pashë qëllimin kryesor të inspektorit shqipfolës policor, qëllimi i tij ishte që edhe unë të bëhesha njëfarë lloj bashkëpunëtori për spiunimin ndaj shoqërisë sime si edhe ndaj shqiptarëve të tjerë në përgjithësi këtu në SHBA, pasi se shteti jugosllav ua kishte frikën më të madhe këtij emigracioni shqiptarë edhe kroatë në shtetin amerikan.

Gjatë viteve 1970-1990 kishim një lëvizje të madhe anti-jugosllave në Amerikë, si dhe një numër i madh akcionesh anti-jugosllave nga grupet e ndryshme ustashtë - kroatëve, por edhe të shqiptarëve të cilët shumë herë iu kishin bashkangjitur edhe këtyre grupeve kroatë. Me kalimin e kohës, më vonë edhe shqiptarët nga pakënaqësitë që kishin ndaj sundimit sllav filluan të ngrisin zërin e tyre dhe t'i shpeshtojnë protestat e tyre anti-jugosllave. Meqenëse po kthehesha nga një qendër e madhe ku ishin të përqendruara shumica e këtyre grupeve anti-jugosllave, në qytetin e Cleveland'it menduan se do të më shfrytëzojnë mua në spiunimin edhe ndaj këtyre njerëzve dhe grupeve të ndryshme që kishin për qëllim shkatërrimin e këtij shteti të brishtë jugosllav. Pas një ore, përsëri ky farë inspektori disi edhe më tepër e më i nevrkosur se në ditën e më parme, më urdhëroi që përsëri të kthehesha në shtëpi te familja dhe të kujtohem edhe më tepër që kur të kthehem të nesërmen në takimin vijues, me të të jem i gatshëm për t'u përgjigjur që të gjitha pyetjeve që atij po i

interesonin.

Tani për mua kjo ende poshtë e lartë u bë e zakonshme, dhe të nesërmen përsëri u ktheva në të njejtin stacion policor, në kohën që më kishte caktuar inspektori shqipfolës Remzi. Mirëpo menjëherë posa hyra mbrenda zyrës së tij, po dukej se ky takim nuk do të zgjasë shumë, pasi se kur u pyeta se a kisha mendu për pyetjet e dhëna nga dita e më parme, unë iu përgjigjeja menjëherë se "E ke të njejtën përgjigje sikurse ta dhash që nga dita e parë, poashtu edhe gjatë ditës së djeshme"! Inspektor Remziu siç shihej nga fytyra e tij, ai nuk mundi të përmbahet më nga mllefi që kishte ndaj meje, për menjëherë disi atij i hypi gjaku fytyrës dhe me nervozë të madhe më tha: "Ik, shko mendo mirë, edhe eja përsëri nesër në të njejtën kohë, por me kusht nëse nuk na tregon neve për këto që po të pyes, ne do të ndërmarrim masa që nuk kanë për t'ju pëlqyer aspak juve! Tani vetëmse po shihej se po përgatitej diçka befasuese për mua. Nuk po mërzitesha aq shumë, sepse unë për vete ia kisha aritë qëllimeve të mia, sepse i kisha takuar dhe parë më të dashurit e mi. Tani çkado që të ndodhë isha i përgaditur të ballafaqohem.

Para largimit nga zyra e tij përsëri i thash: "Unë po shkoj, por edhe nesër kur të kthehem i ke po të njejtat fjalë dhe të njejtën përgjigje, pasi ato janë fjalët e mia të së vërtetës!" Meqenëse zyra e Remzi inspektorit ishte në katin e dytë të stacionit policor, u lëshova shkallëve teposhtë edhe dola nga godina për të cilën tani isha vizitor i përditshëm. Por, jo nga dashuria ime për to. Në të dalur jashta dyerve të hyrjes, takova një bashkëvendas timin me të cilin shkëmbyem një bisedë të shkurtër. Nga bashkëvendasi im kuptova se këtij të shkretit po i njejtë inspektor policie ia kishte humbë edhe vendin e punës së përkohshme të tij që e kishte në Gjermani. Me këso lloj të njejtë kushtëzimesh dhe shantazhesh, që të bashkëpunojë dhe spiunojë për shokët e tij, bashkëkombasit, ose nuk do t'i lirohej pasaporta e uzurpuar nga ky farë inspektori, e pa të cilën dokument nuk kishte mundësi udhëtimi për në vendin e punës së tij jashtë kufinjve jugosllav. Sikurse në dy ditët e më parme edhe në ditën e tretë inspektori policor e filloi me të njejtin refren. Po edhe me të njejtat pyetje, për të cilat nuk mori përgjigjen që aq shumë ai po e dëshironte. Në fillim të takimit të sotëm u tregua më i butë, por menjëherë pas ndëgjimit të fjalëve të para të mia, ai ndryshoi për 180 shkallë qëndrimin e tij ndaj meje! Në fillim kërkoi përgjigjen disi edhe më të zemëruar dhe me ton edhe më të lartë, dhe pastaj mu kërcënua me fjalët: "Tani mund t'ju rrahim por edhe t'ju burgosim!" Dhe derisa po fliste me ton të lartë kërcënues inspektori, ai u përkul prapa tavolinës edhe u pa se po mendohej të merr diçka! Pasi u ngrit me trupin e tij të kërrusur, prej poshtë me të dy

duartë e tij e nxorri një kuti të madhe kartoni dhe e vuri para meje mbi tavolinë. Një kuti e cila ishte e stërbushur me libra, gazeta, letra, fotografi dhe disa disqe, por njëri që shihet mbi të gjitha ishte i veçuar, e ai ishte një disk gramfoni i atdhetarit të madh Jusuf Gërvallës. Po, një këngëtar dhe poeti brilant, që me kitaren e tij kishte bërë këto hite që i ndëgjoni gjatë studimeve të cilin disk ma kishin marrë gjatë bastisjes së shtëpisë time në Llojan kur kishin ardhë që të më arrestonin! Kishte ndodhur një ditë pas largimit tim për në shtetin e Austrisë. Siç kuptova më vonë nga të afërmit e mi, pas bastisjes së shtëpisë ma kishin arrestuar edhe vëllain Murtezanin, të cilin e lironë pas disa ditësh pas intervenimit të miqëve dhe familjarëve të mi. Pasi pashë kutinë me sendet e mia, disi edhe mua më kapi inati për atë që kishin bërë dhe nuk munda të durohem më. Më tepër e kisha nga mllefi ndaj këtij shqipofolësi kur pashë se një pjesë e jetës time paska qenë e burgosur për të tëra këto vite duke më konfiskuar edhe gjërat më personale nga këta njerëz shpirtëlligë, si inspektori famëkeq Remziu i cili po fryhet këtu si një person me reputacion. Për njëherë ia ktheva: "Po, ju mundë ta bëni edhe burgosjen time, po edhe të më keqtrajtoni, por ma merr mendja se brenda 24 orëve do të jeni të detyruar për të më liruar. Ju nuk jeni ata që mundë të vendosni për fatin tim siç po e bëni për shumicën dërmuese të shqiptarëve, unë jam nënshetetas i një shteti tjetër që do të kujdeset edhe për mua!" Ky xhelat i shqiptarëve nuk ishte mësur që dikush nga viktimat e tij t'ia kthejë fjalën! Në mënyrë cinike mu kthye dhe më tha: "Ooo, po ti qenke edhe kokëfortë, po edhe po dijshe bukur shumë!"

Nga kutia që ndodhej në mes nesh mbi tavolinë, inspektori Remziu nxorri disa letra që i kisha të shkruara nga shoqja e tani bashkëshortja e jetës time Shahadija gjatë kohës në shkollë të mesme dhe studime! Më vonë me letrat nxorri edhe disa karta festive që më kishin dërguar të afërmit edhe shoqëria ime për festat e ndryshme të vitit, e në veçanti ato të 28 Nëntorit të festës sonë kombëtare ditës së shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Këto karta postale ishin një lloj kolazhi fotografishë me fytyrat më eminente të lëvizjeve shqiptare. Në njërin prej këtyre kartë postaleve e cila kishte personazhet më kryesore të historisë kombëtare të shqiptarisë, në atë kartë postale figuronin foto nga shtatorja e Skenderbeut në Krujë, portreti i diplomatit dhe atdhetarit Hasan Prishtina, si dhe trimi i maleve Isa Boletini, që më ishte dërguar nga djali i dajës dhe shoku i studimeve patrioti Muharrem Shaljami. Ai po e fillonte me shkrimin që në rreshtin e parë me fjalët: "Shqiptarit të Llojanit!", të cilët fjalë m'i lexoi me zë të lartë vetë inspektori Remziu dhe tundi kokën si me e pasë kapë rufeja, dhe m'u kthye dhe më i mllefosur duke më pyetur mua: "Çka ka deshtë me thënë Muharremi me këto fjalë, shqiptarit të Llojanit?" Nuk munda ta durojë më dhe menjëherë ia ktheva përgjigjen, "Po, ti a nuk po e kupton se ç'ka ka deshtë me thënë? Unë po iu

shpjegojë se unë jamë shqiptarë, babën, nënën, gjyshin edhe katragjyshin i kam pasë shqiptarë dhe kuptohet vetvetiu se edhe unë jamë si ata shqiptar. Mendoj se Muharrem Shaljami asgjë nuk ka shtuar apo gabuar!" Në bazë të bisedës që kishim zhvilluar gjatë ditëve të kaluara, inspektori Remziu që nga fillimi gjithëqysh fuste bisedën në ndërlidhjet tona me Muharremin. Sipas mendimit tim ai po mundohej të rihapte ndonjë lëndë të re, që të ripadisë apo edhe që ta burgosë Muharremin i cili veçse e kishte kryer mbajtjen e denimit 5 vjeçar me akuzën pa lidhje si armik i përbetuar kundër popullit dhe shtetit jugosllav! Muharremi asnjëherë nuk kishte rreziku askend, e as shtetin jugosllav sepse ata nuk kishin ndërmarrë kurrfarë aksioni që të përmbysin regjimin... Si duket nga përgjigjeja që i dhashë Remziut, ky ishte edhe kulminacioni i arritur për këtë inspektori fatkeq i cili u ngrit në këmbë edhe me ton të lartë ma priti: "Ne këtu jemi edhe më shqiptar se sa që jeni ju, edhe disa njerëz të tjerë që flasin si ju!" Pastaj u përku pakë edhe nxorri nga fjoka e mbrendisë së tavolinës së tij edhe pasaportën time amerikane të cilën ma kishte marrë para tre ditësh polici kujdestar në hyrje të stacionit policor për të më bërë regjistrimin e paraqitjes time në policinë lokale të Kumanovës. Remziu nxorri pasaportën time edhe ma përplasi përpara meje duke më thënë me një gjest idiotesk: "Ja merre!" Pas këtij gjesti të tij edhe unë u nxeha në kokë edhe ia ktheva: "Faleminderit, e dija se do të ma jepni pasaportën para se të largohem prej këndeje, kjo nuk është pasaporta e juaj dhe ju nuk mundë që ta mbani!" Menjëherë pa pritë aspak edhe ai ma priti edhe atë me shumë mllef duke më thënë: "Çe mere pasaportën, edhe shporru menjëherë prej këndeje, edhe nga ky moment ti je i shpallur nga ne: PERSONA NON GRATE / PERSON I PA DËSHIRUAR, dhe tani ti ke kohë vetëmse 24 orë për ta lëshuar vendin dhe të gjendesh jashtë kufirit jugosllav. Poqëse kapesh pas kësaj kohe mbrenda kufinjve jugosllav, ti ke për t'u arrestuar dhe burgosur!" Pas këtij lajmi që më dha inspektori shqipfolës Remzi Saliu, përsëri ia ktheva edhe unë: "Tani edhe pse po më dëbon nga familja dhe vendelindja, unë për veten ia arrita qëllimit tim. Unë që të gjithë njerëzit e mi që i deshta dhe i dua i pashë dhe u çmallëm me to, tani edhe pse po më dëbon, përsëri jam i kënaqur!" Para largimit nga zyra e tij, inspektori Remziu ma mori diskun që ishte mbi të gjitha sendet e mia të konfiskuara prej tyre, atë të Jusuf Gërvallës duke ma bërë me dije se ky disk nuk lejohet të mbahet dhe duhet konfiskuar. Më tregoi se më kishin konfisku edhe maqinën e shkrimit, të cilën axha im ma kishte sjellë prej Austrisë gjatë kohës time në studime për të cilën më tha se kinse e paska marrë një inspektori tjetër shqiptar i quajtur Bexhet Bexheti me detyrë në Shkup. Gjoja axha im Emiri ia paska pasë falur atij pas bastisjes dhe arrestimit të vëllait tim Murtezanit! Me këtë gjest më bëri me dije se sa të ulët që janë këta të punëve të brendshme të UDB's, hajna e ordinerë, që para syve të vjedhin, por kinse me arsye!



Me familjen

Pasi mora pasaportën, e kapa edhe kutinë me libra dhe letrat e mia që ishin aty edhe me të shpejtë dola jashtë zyrës së tij, por pa u përshëndetur. Disi i mërziur më tepër për nënën dhe motrën pas këtij lajmi jo të mirë, u lëshova shkallëve te poshtë edhe shkova drejtë në godinën tjetër që ishte në krahun tjetër të postës së Kumanovës e cila ishte jo shumë largë nga kjo derë e kobshme e policisë gjatë ndaj shqiptarëve. Posta ndoshta ishte rreth 50 metra nga dyert e stacionit policor në të njëjtën anë të rrugës kryesore që përshkon përmes qytetit të Kumanovës në drejtim të Shkupit. Hyra brenda dhe u ngjita shkallëve përprjetë dhe shkova në katin e dytë, ku dhe kërkova njërin nga kabinet e lira të telefonit që menjëherë ta njoftoj Ambasadën Amerikane në Beograd për të gjitha ndodhitë e mia me policinë e Kumanovës. Më tepër dëshiroja edhe që t'i pyes se si duhet vepruar pasi se kisha nënshetësinë amerikane, dhe këta të policisë së Kumanovës më kishin shpallur me status "Persona Non Grate / Person i Pa Dëshiruar" pra policia e Maqedonisë?

Në anën tjetër të telefonit m'u paraqit dikush nga stafi i Ambasadës Amerikane në Beograd dhe pyetja e parë e tij ishte se policia e Maqedonisë a ma kishte kthyer pasaportën time amerikane, e cila më ishte konfisku nga fillimi që në ditën e parë të takimit tonë në hyrje të stacionit policor të Kumanovës. Më pyeti a isha maltretuar fizikisht po edhe psikikisht nga forcat e sigurimit maqedon? I tregova të vërtetën për të gjitha rrjedhat deri te vendimi për dëbimin tim nga shteti jugosllav. Stafi i Ambasadës Amerikane në Beograd me të cilin kontaktova më këshilloi që të largohem sa më shpejtë nga shteti jugosllav, domethënë brenda afatit 24 orësh, me qëllim që mos të kisha ndonjë telashe tjetër me arrestime apo maltretime të tjera. Gjatë bisedës më treguan si shembull edhe për një rast të ngjajshëm e që i kishte ndodhë edhe disa Shqiptaro-Amerikanëve të Malit të Zi, të cilët gjatë vizitës së tyre në familjet e tyre ishin arrestu, e pastaj sesi ishte deshtë që edhe Ambasada Amerikane në Beograd të intervenojë për lirinë e tyre.

Këshilla tjetër nga stafi i Ambasadës Amerikane ishte: sa të arrijë në Amerikë, t'i shkruajë në letër pikë e për pe për ndodhinë time në policinë e Kumanovës, edhe atë letër duhet drejtuar Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, e në veçanti Seksionit për Punë të Jashtme, si dhe Senatit Amerikan, e që pastaj ata të bëjnë protestën e tyre zyrtare kundër regjimit jugosllav ndaj nënshetetasve amerikan, si dhe për maltretimin e qytetarëve tanë. Me të dalë nga posta e mora një taksidhe menjëherë u ktheva për në Llojan në shtëpinë tek familja, të cilët po më prisnin me pa durim për të ndëgjuar se ç'po ndodhte me statusin tim. Ishin shumë kureshtarë të dijnë se pse po maltretohesh, kur ende nuk ishim parë aq shumë kohë që të çmallshim në mes vete, sepse ende nuk kisha bërë asnjë javë që kur kisha arritur aty. Pas arrijtes sime në shtëpi, që të gjithë u habitën kur më panë me atë kutinë përplot me letra dhe libra, librat të cilat familjes sime ua kthyen memorien nga koha kur ishte bastisë e tërë shtëpia dhe kishin konfiskuar të tërë ato gjëra, si dhe arrestimi i vëllait. Pasi pushova pakë, pas një kohe të shkurtër iu tregova storiën se çka më kishte ndodhur në stacionin policor duke i thënë më tepër si në hajgare: "Tani nënë e dashur, ne e bëmë tonën dhe të lutem mos, të lutem që mos të mërziemi aspak se tani ne u pamë dhe u çmallëm sado pakë, edhe unë iu premtojë se përsëri do të vijë, pasi se për momentin policia e Maqedonisë më kanë shpallur si person jo të mirë për to, edhe më kanë dhënë një afat 24 orësh që të largohem nga „ky shtet i fëlliqur sllav"! Nënës nga këto fjalë gati se sa nuk i ra të fikët, i erdhi tepër keq që të gjithëve që ishin mbledhur aty, por kuptohet më së keqi e përjetoi nëna e cila po më priste pas kaq vitesh që nuk munda të vijë, e cila më përqafoi me të dy duart e saja të ngrohëta dhe më puthi në ballë, dhe ashtu me lot në sy nëna ma ktheu: - "Uh, thivi e hangërt atë farë inspektori shqiptar, pse me të përzan bash ty nga shpija jote, e atij shpija iu kalltë atij shkau dhe kurrë mos paftë ditë të marë në jetën e vetë, çysh me na e ba neve ai kështu!" Ishin mallkimet e nënës së

shkretë për të birin e sajë, që mezi kishte pritë të tërë këtë kohë të gjatë për t'u takuar...

Të nesërmen para dite e mora rrugën për në Prishtinë, për të shkuar që të takoj kusheririn tim, djalin e axhës Sejdiun i cili tani ishte i martuar dhe kishte gruan me dy fëmijët e tyre. Ata po jetonin në një podrum të një ndërtese që e kishin adaptuar në banesë banimi, diku në afërsi të Ulpianës në Prishtinë. U nisa për të shkuar te Sejdiu me qëllim që ta marrë atë e që të më shoqërojë dhe të shkojmë për në Greqi, jashta kufirit jugosllav, me qëllim që t'i largohem ndonjë arrestimi policor për shkak të statusit që më kishte caktuar inspektori Remzi Saliu në stacionin policor të Kumanovës.

Në Prishtinë u takuam me Sejdiun dhe i sqarova problemin që kisha, ku i kërkova që nëse kishte kohë edhe pse ishte i pa punë, me leje të familjes që të nisemi menjëherë për në Greqi, sepse nuk kisha aq shumë kohë që të qëndroja brenda kufinjve jugosllav, e që tani veçse ishte dikur pas dite. Pas tregimit se ç'më kishte ndodhur edhe e shoqja e Sejdiut, Sehija u pajtua që Sejdiu të vijë me mua dhe të më shoqërojë. Në të njëjtën ditë u nisëm me autobus prej Prishtinës drejt Shkupit, që pastaj në mbrëmje të niseshim me trenin ndërkombëtar për në Janinë të Greqisë. Prej aty pastaj do të vazhdojmë për në ndonjë vend bregdetar të Greqisë për të kaluar kohën, sa më kishte mbetur deri në ditën e kthimit tim për në Amerikë. Në Greqi shkuam dhe u vendosëm në një fshat të njohur turistik diku rreth detit të quajtur Asprovalta. Në këtë fshat morëm një banesë afër plazhit, mirëpo pas dy-tre ditësh filluam të mërziemi sepse ishim të vetëm dhe gjithçka na ishte monotone! Gjatë bisedës me Sejdiun menduam dhe vendosëm se ndoshta do të ishte mirë që të kthehemi përsëri në Prishtinë, dhe për ta provuar që të parqitem te miqësia e tij sepse ata njiheshin shumë mirë në Prishtinë, çka edhe ashtu vepruam. Pasi u kthyem në Prishtinë u takuam edhe me miqtë e Sejdiut, Dr. Prof. Rexhep Qosjen si dhe vëllain e tij Isa Qosjen të cilëve i tregova rastin se ç'më kishte ndodhur me policinë maqedone edhe pse ata veçse ishin informuar

më herët për ndodhitë e mia nga Sehija bashkëshortja e Sejdiut e cila ishte e mbesa e tyre. Pasi u konsultuam pak me miqtë e Sejdiut, njëri prej tyre regjisor i mirënjohur shqiptar, z. Isa Qosja më tha që të shkojë dhe të paraqitem tek një shok i tij që kishte, i cili po punonte në stacionin policor të Prishtinës, për t'u regjistruar për leje qëdrim në

Prishtinë. Të nesërmen pasi u zgjuam, unë me Sejdiun shkua në stacionin policor të Prishtinës, atje ku para shumë vitesh gjatë kohës sime të studimeve kisha kaluar një ditë të tërë në hetim! Pas arrijtes në hymje të stacionit policor aty ku ishte roja policore, e kërkuam personin që e njihje dhe te i cili na drejtoi Isa Qosja. Mirëpo për fat timin ai person nuk kishte qëlluar në punë gjatë asajë dite, mirëpor roja të cilin e pyetëm ai ishte i kombësisë serbe, por fliste shumë mirë shqipen dhe i cili nga kureshtja më pyeti në shqip se për çfarë po e kërkonim atë personin policor shqiptarë? I treguam se dikush na ka dërguar që të takojmë atë person në lidhje me regjistrimin tim, sepse jam me nënshtetësi të huaj. Polici serb u tregua shumë zemërmirë, u zgjat nga tavolina që kishte përbrenda dhe nxorri një karton regjistrimi dhe më kërkoi pasaportën time amerikane dhe më tha: "Merre dhe plotësoje këtë karton, dhe pastaj pas plotësimit ma jep që ta vulosim dhe ta bëjmë regjistrimin tani për menjëherë. Pra, nuk keni nevojë që ta presësh derisa të vijë ai kolegu që po e kërkoni ju! Pas dhënies së pasaportës dhe derisa po e regjistron në fletoren e tij zyrtare, polici serb filloi të më pyes mua se si ishte jeta në Amerikë, sa janë pagesat e punëtorëve, si dhe për demokracinë e madhe në shtetin amerikan! Pas disa minutash e kryem regjistrimin, e faleminderova dhe u përshëndetëm me policin serb sikurse të ishte dikush që po njihnim prej shumë kohe më herët. Tani u bëra me leje qëdrim legal të Prishtinës, po nga ana tjetër edhe i shpallur si person i pa dëshiruar po nga i njejtë shtet.

Tani vendosa që ditët tjera edhe sa më kishin mbetur që t'i kaloja te kusheriri Sejdiu në banesën e tij të vogël që nuk kishte aq shumë vend. Nuk kishte vend për një person e ku më për 5 njerëz në podrumin e adaptuar me kushtet e mjerueshme për jetesë, por me plotë dashuri. Gjatë fundjavës, të shtunave vonë në mbrëmje shkonim që të vizitonim nënën dhe të afërmit tjerë në Llojanin tim të dashur, dhe të ktheheshim të nesërmen të dielave në mbrëmje, me qëllim që mos të më shohë askush përveçese anëtarëve të familjes! Gjatë qëndrimit tim në Prishtinë më erdhi befasisht në vizitë edhe e dashura ime Shahadija, me të cilën ende nuk ishim parë apo ndëgjuar nga telashet me policinë e Kumanovës që më dolën. Shahadija ishte prekur pamasë me mua se pse nuk ia kisha treguar planet e mia të largimit para ikjes time në Amerikë. Të hidhëruar, por edhe më tepër të dashuruar, rifilluar lidhjen që kishim dikur, çka don të thotë se tani për menjëherë aty na u shtua edhe një anëtar më i ri familjes së Sejdiut. Marrëveshja e re me Shahadijen ishte që unë duhet të shkojë në

Kaçanik dhe të takoja vëllain e vetëm që kishte ajo Maksut Hoxhën, dhe t'i tregoj atij "Burrë me burrë" për lidhjen tonë që kishim. Pas dy ditësh shkova në Kaçanik dhe e takova Maksutin, i cili ishte një burrë me profesion inxhinier i gjeodizisë, por edhe me kulturë të gjërë i cili më mirëpriti shumë mirë dhe tha: "Nëse ju jeni marrë vesh mirë në mes veti se si të jetoni, sa për mua, unë nuk kam kurrëfarë kundërshtimi të juajin!" Tani gjërat po lëviznin shumë shpejtë dhe nuk kisha shumë kohë pasi se po afrohej dita e ikjes sime nga Jugosllavia. Vendosëm që sa më shpejtë të fillojmë me ceremoninë e fejesës, dhe pas disa ditësh të bëjmë edhe kurorëzimin. Vendosëm që gjatë vikendit në shtëpinë e familjes time në Llojan të dërgohet shenja e fejesës tonë, por pa bërë kurrëfarë ceremonie. Nuk duhej bërë aq publike që mos të ndëgjohej aq shumë, sepse kisha problemin e policisë! Shenjën e fejesës tonë në Llojan e sollën daja i Shahadijes Nehat Hoxha nga Prishtina me nipin e Shahadijes Prof. Dr. Fadil Raka, që e pata edhe profesor në gjimnazin "Skenderbeu" të Kaçanikut, si dhe kusheririn e sajë Inxhinierin Selim Hoxha. Tani ishin edhe ditët e fundit që më kishin mbetur para kthimit në Amerikë, edhe mu për atë në mbrëmjen para udhëtimit tim vendosëm që të bëjmë kurorëzimin në komunën e Kaçanikut, për t'i ikë kontaktit me policinë e Maqedonisë. Në komunën e Kaçanikut shkua vonë në mbrëmje me një bomboniere edhe dy dëshmitarë, ku para ofiqarit bëmë edhe lidhjen e martesës! Të nesërmen herët në mëngjes, së bashku me Shahadijen u nisëm me autobus nga Prishtina për në Beograd, për ta bërë kurorën legale edhe para stafit të Ambasadës Amerikane në Beograd që të kryhet edhe dokumentacioni më lehtë edhe më shpejtë për bashkimin familjarë në Amerikë. Në Beograd arritëm herët në mëngjes, menjëherë nga stacioni i autobusave shkua në Ambasadën Amerikane, hymë brenda dhe e kryem betimin para stafit të ambasadës dhe u kthyem menjëherë për në Prishtinë. Nga Prishtina shkua në Llojan, u përshëndetëm me familjen, dhe të nesërmen herët në mëngjes u nisa për në Amerikë nga Aeroporti i Shkupit. Pas kthimit tim në Amerikë, nga maltretimi policor që pata në Kumanovë, tani vazhdova edhe më tepër që të angazhohem, edhe atë në të gjitha mënyrat dhe me lloje të ndryshme të aktiviteteve për çfaqjen e pakënaqësive të popullit shqiptarë ndaj shtetit Jugosllav, duke shkuar deri edhe në instancat më të larta të shtetit amerikan.

Pas një viti bëmë bashkimin familjarë me të fejuarën time Shahadijen, me të cilën më vonë familjes tonë i shtohen edhe dy vajzat e bukura, Liridona dhe pas një viti edhe vajza tjetër Mimoza. Në Qershor të vitit 1992 bëmë një lëvizje nga Cleveland'i për të vazhduar jetën në Brooklyn të New York'ut. Meqenëse kisha eksperiencë të madhe në gastronomi u punësova në restorantin e mirënjohur të patriotit dhe lobuesit të madh për çështjen shqiptare të Mustafë Bytyqit, pronar



10 Prill 2004 Lakewood /SHBA, në takim me kryetarin e qytetit Thomas J. George kryesia e SHSHA Ilir Shyti, Ajaz Emini dhe Sako Satka

i restorantit "The Grand Ticino". Ky lokal ishte i njohur nga skenat filmike të filmit klasik shumë të njohur "Moonstruck", që kishte personazhet kryesore që loznin: këngëtarja e mirënjohur Cheri dhe aktori i madh Nicolas Cage. Pronari shqiptar Mustafë Bytyqi dhe familja e tij ishin aktivistë më të mëdhenjë të çështjes shqiptare, ishte vëllau i tij Sejdi Bytyqi si dhe miku i tij Elez Biberaj kryeredaktor i "Zërit të Amerikës". Gjatë kohës sa punova te vëllëzërit Bytyqi, aty njoha edhe më shumë atdhetarë dhe patriotë të mëdhenjë të kohës si: arbëreshin At Bellushi, poetin Tahir Deskun, aktivistin nga Shqipëria Ilir Demalia dhe shumë e shumë të tjerë. Gjatë kohës sa ishim në New York, iu bashkangjita shumicës së aktiviteteve që organizoheshin nga komuniteti i madhë shqiptarë që kishte New York'u.

Pas shkatërrimit të shtetit jugosllav, dy muaj pas lindjes së vajzës së parë Liridonës, në Korrik të vitit 1992 unë me Shahadijen edhe vogëlushen e posalindur Liridonën, morëm rrugën për në vendlindje, por kësajë here udhëtimit ynë do të bëhej në relacionin nga New York'u për në Sofje të Bullgarisë, ku pastaj dhëndërri Sabri Hasani nga fshati Çerkez i Kumanovës do të dilte që të n'a merrte me makinën e tij nga aeroporti i Sofjes që të vazhdonim udhëtimit për tek familja në vendlindje, në fshatin Llojan të Kumanovës. Në rrugën për në kufirin maqedon, afër Kriva Pallankës arritëm në ora 11:30 para mesnate. Polici kufitar që ishte aty na kërkoi të gjithëve pasaportat e udhëtimit, i cili i mori që të gjithë edhe shkoi në zyrën e tij për t'i bërë kontrollën edhe vulosë ato. Pas disa minutash i njejtë polic u kthye me pasaportat e të gjithëve në dorë përpos timit, dhe më urdhëroi që të dalë nga makina menjëherë duke më vënë prangat në duar, e të tjerëve me mua iu tha që të vazhdojnë rrugën e udhëtimit! Të shokuar të gjithë nga kjo që po më ndodhte si dhe nga pamja groteske duke më parë mua të prangosur sikurse me pasë qenë ndonjë terrorist, e sikur të kisha kryer ku me e ditë se çfarë krimi! Shahadija edhe Sabriu pyesin me habi policin se ç'po ndodhë, edhe pse po bëhet arrestimi? Polici thotë: "Jo s'ka asgjë,

por Ajazi duhet të ndalet këtu në kufi dhe më vonë do të shoqërohet për në stacionin policor të Kriva Pallankës. Arsyeya është se pse këtu në kompjuterin tonë ka një pikë të kuqe edhe duhet që të arrestohet, edhe ne nuk guxojmë që ta lëshojmë të udhëtojë më tutje derisa të mirremi vesh me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Maqedonisë në Shkup. E kjo do të ndodhë në ditën e nesërme pas orës 10:00 të mëngjesit, pasi se të fillojë orari i rregullt i punës. Unë iu luta familjarëve të mijë që të nisen pa mua dhe të vazhdojnë rrugën sa më shpejtë për Llojan, sepse ishte tepër vonë. E kujtoja nënën e shkretë e cila sigurisht se mezi po na priste që të na shohë. Athua tani si do ta pranojë këtë lajm, se si djali i sajë që po e priste nuk do t'i arrijë në shtëpi sonte sepse ishte arrestuar dhe po mbahej në stacionin policor të Kriva Pallankës.

Mua më futën të prangosur në një dhomë të vogël të doganës, që të presë derisa të vijë policia e Kriva Pallankës për të më marrë, e për të më transferuar në stacionin policor të tyre. Pas 15 minutash erdhën policia me makinën e tyre dhe ashtu të prangosur më futën në makinën e tyre edhe më dërguan në stacionin policor të Kriva Pallankës. Aty kalova natën në një sallë të përmasave më të mëdha që kishin aty, ku ishin edhe disa oficerë tjerë policor që po pritnin në gjendje të gatshme për çfarëdo që kërkohet. Disa minuta pas arrijtes time aty, njëri nga policët e moshës së re që ishin aty me ato më pyeti mua se pse isha arrestuar që më kishin sjellë këtu? Unë i tregova të vërtetën se nuk kisha kurrëfarë njohurie se pse u arrestova, pasi se asnjëherë nuk e kisha thyer ligjin si në ish Jugosllavi, e bile edhe më hiç në SHBA. Pas një bisede të shkurtër me policin i cili siç po shihej ishte mjaftë kureshtarë për jetën amerikane, më vonë dikur pas një ore po i njejtë polic iu kthye shokut të tij edhe po i thotë: "Nuk e kuptoj pse ne po e mbajmë këtë njeri të lidhur me pranga, kur ky njeri s'ka bërë asgjë! Çka thua, a t'ia heqim prangat"? Ai e shikoi shokun e vetë dhe i tha: "Shko zgjidhe". Polici kureshtar edhe shpirt mirë menjëherë erdhi dhe m'i hoqi prangat nga duart! Më vonë aty nga ora 2:30 pas mesnate po i njejtë polic

kureshtarë mu afrova edhe po më thotë: "Po deshte të shtrihesh, kemi një qeli të errët poshtë dhe një pallto të vjetër, aty ku mundesh për të shkuar edhe me fjetë i qetë, por nuk është vend aq i pastërt. Iu faleminderova edhe iu luta nëse nuk prishë punë që të pushoja aty ku isha, në karrigen i mbështetur në një tavolinë të madhe, sigurisht për punët e tyre. Të nesërmen pas orës 11:00 para dreke, disa fillova të ndihem si i harruar sepse askush s'po më thoshte asgjë dhe fillova të bëhem i pa durueshëm, pasi se ende nuk kishte kurrëfarë lajmi se pse po mbahesha aty? Dikur njërin prej tyre e pyeta, se në çfarë kohe është autobusi i fundit për në Kumanovë? Me qëllim që të paktën të kapi lidhjen e fundit prej Kriva Pallankës! Polici më tregoi se autobusi i fundit për sot për në Kumanovë ishte në orën 15:00 pas dite. Pas këtijë njoftimi të orarit të autobusit më hyri frika: po nuk morën ndonjë urdhër për lirim tim së shpejtë?! Kisha frikën se do të mbetem edhe një natë në këtë stacion policor të Kriva Pallankës! Dikur vonë aty nga ora 14:00 po ndëgjoja zilen e telefonit, mirepor nuk po mundesha të ndëgjoja asgjë se ç'po bisedonin. Në fund të bisedës polici u kthye drejt meje dhe më tha: "Mos u mërzit aspak, se s'qenka asgjë, ajo pika e kuqe në kompjuter qenka një loj ndalese për shkak se ti nuk paske kryer obligimin ushtarak, e tani meqenëse nuk jemi më Jugosllavi, ti duhesh që të shkosh në zyrën e Departmentit Ushtarak në Kumanovë, edhe t'iu tregosh se nëse don të shkosh në shërbimin ushtarak ose edhe mundesh që ta refuzosh, askush nuk të pengon. Por, duhesh patjetër që ta nënshkruash vendimin që mos të kesh pengesa për më tutje!" Ishte e vërtetë, se unë nuk kisha kryer obligimin ushtarak për shkak se gjatë kohës së rinisë isha në studime, e zakonisht pas studimeve shkonim që të kryenin shërbimin ushtarak! Pas këtijë lajmi, me shpejtësi dola nga stacioni policor për në pikën më të afërt ku mundë të pritej autobusi i fundit për në Kumanovë. Ende pa arritur në atë pikë ndalese të autobusit, po shihej se autobusi veçese arriti para meje, u ndal dhe me të hapur dyert me

vruull hyra brenda tijë dhe u nisëm për në Kumanovë, dhe kështu mezi e zura. Ishin sekondat e fundit për të mos mbetë edhe një natë tjetër në Kriva Pallankë! U nisëm drejt Kumanovës, dhe pas rreth një ore udhëtimit arritëm atje ku ishte dashtë të isha një natë më herët. Nga Kumanova mora një taksi dhe për 20 minuta arrita në shtëpi, aty ku ishin mbledhë e gjithë familja edhe po më prisnin se kur do të arrija. Në arrije i dëftova të gjitha ndodhitë e mia dhe gjithçka në lidhje me arrestimin tim, që përngjante si në filma. Biseduam dhe u çmallëm mes vete, filluam të hajmë edhe darkën sepse kishte mëse 24 orë që nuk kisha futur ushqim në gojë. Isha i rraskapitur nga udhëtimi i gjatë dhe telashet e udhëtimit, si dhe nga ky arrestim i kotë!

Me t'u zgjuar të nesërmen në mëngjes, zbrita në qytet dhe menjëherë shkova në entin e departamentit ushtarak të Kumanovës, dhe pasi se i tregova arsyen pse kisha shkuar, njëra nga punonjëset në zyrë e nxorri një formularë dhe m'i tha po të njëjtat fjalë sikurse oficeri policor. Edhe ajo më tha: Kjo është nëse dua t'i bashkangjitem shërbimit ushtarak mundem ose edhe mundë ta refuzojë me nënshkrimin e formularit. E mora formularin dhe pa menduar aspak e nënkrova refuzimin e shërbimit ushtarak dhe ika me të shpejtë nga zyra tani si njeri krejtësisht i lirë! Me prishjen e shtetit jugosllav, tani edhe Maqedonia ishte bërë shtet në vete, dhe të gjitha gjërat po edhe ligjet kishin ndryshuar. Edhe inspektor Remzi Saliu tanimë nuk kishte pozitën e inspektorit që kishte patur kur më shpalli person i pa dëshirueshëm për shtetin jugosllav. Tani sa ndëgjova se tani ai më nuk kishte kurrfarë pozite, e bile edhe kishte qenë i arrestuar dhe maltretuar prej shokëve të tijë që ende ishin në detyrë.

Gjatë qëndrimit tim në vendlindje, pas një jave pata edhe takimin e parë pas disa vitesh me inspektor Remziun, shqipfolësin i cili shoqërohej me shoqërinë e dhëndërrit tim Sabri Hasanit. Takimi ishte i rastësishë.

Sabriu kishte një çajtoreshë në qendrën e qytetit, ku kishim lënë takim me qëllim që më vonë të shkonim së bashku te motra për të kalu një natë me to. Në të arritur te çajtorja, aty gjeta si zakonishtë shoqërinë e njejtë të Sabriut. Por, kësaj here në mesin e tyre kishte qëlluar edhe inspektori i dikurshëm Remziu. Meqenëse shumica e dinin ngjarjen time me inspektor Remziun e famshëm, disi që të gjithë u befusuan kur më panë, por më dëshiruan mirëseardhje. U përshëndetëm me shtrëngim duarsh një nga një në radhë, por, kur arrita te Remziu e kalova pa ia dhënë dorën. Gjesti im i dëshpëroi pa masë shumicën prej tyre, kurse Remziu me të shpejtë i kërkoi falje shokëve, u ngritë në këmbë dhe iku menjëherë! Pas largimit të tijë, meqenëse njiheshim me shumicën prej tyre, ata thuaj se njëzëri menjëherë filluan të më qortonin, se unë paskam bërë një gjest shumë të ulët pse nuk ia dhash dorën edhe atij i cili më kishte shpallë si "Person i Pa Dëshiruar". Pas një kohe të shkurtë

që të gjithë u ngritën në këmbë edhe u larguan jo të kënaqur nga çajtorja e Sabriut! Disa ditë më vonë përsëri pata rastin të takohemi rrugës me ish inspektor Remziun, por tani derisa më kishte parë në largësi, kaloi dhe iku në anën tjetër të rrugës. Më vonë ndëgjova se gjatë demonstratave të prindërve të nxënësve për shkollimin shqip në Kumanovë, edhe Remziun e përjashtojnë nga puna sikurse shumicën tjetër shqiptare edhe atë e kishin arrestuar dhe maltretuar së bashku me të gjithë shqiptarët e tjerë. Po kjo i kishte ardhur nga ish kolegët e tijë sllavo-maqedon me të cilët ishte vëllazëruar kohëve të më hershme!...

### SI MUNDESHA TË NDIHMOJA LUFTËN E SHENJTË TË KOSOVËS

Pas demonstratave studentore të pranverës më 1981, të cilat u shtypën në mënyrën më brutale me: burgosje, rrahje dhe vrasje të studentëve dhe të gjithë popullatës shqiptare gjithëandej në Jugosllavi, rritet edhe më tepër interesi i medias dhe shtypit amerikan për gjendjen e popullit shqiptarë në ish Jugosllavi. Në Nëntor 1984, Arbëresho-Amerikani Joe Dio Guardi zgjidhet për përfaqësues në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit të SHBA'së, kongresmen i cili u bë edhe shtylla kryesore për zbardhjen dhe aktualizimin e çështjes shqiptare edhe para kongresit dhe Senatit Amerikan. Ku këta Kongresmenë dhe Senatorë Amerikan, më vonë do t'i bashkangjiten kauzës kombëtare të Dio Guardi. Më vonë do t'i bashkangjiten edhe do të shkojnë që t'i shohin ngjarjet në Kosovë prej së afërmi, që të shohin me sytë e tyre popullatën shqiptare të Kosovës se si po shtypeshin dhe po torturoheshin nga gjakpirësit serb. Me ndihmën e ish Kongresmenit Arbëresh Joe Dio Guardi si dhe kryetari të "Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane" edhe aktivistve të tjerë shqiptarë do të mbahen një numër i madhë demonstratash dhe tubimesh anti-jugosllave nëpër shumë qytete ku kishte më së shumti shqiptarë: si në Nju Jork, Detroit dhe Çikago. Por demonstrata më e madhe që mbahet në mendë ishte tubimi më masiv që ishte mbajtur ndonjëherë në Amerikë, ku aty kishte mbi 10.000 shqiptaro-amerikan, ishte tubim i cili ishte mbajtur para Shtëpisë së Bardhë dhe më vonë edhe para Capitol Hills në Washington DC. Tubimi filloi të mbahet përpara Shtëpisë së Bardhë ku ishin mbledhë mbi 10.000 shqiptarë nga e gjithë Amerika. Pas shumë fjalimeve shkua edhe para Kongresit dhe Senatit Amerikan, aty ku vazhduam me fjalime, dhe folësit kryesorë që ishin me ne ishin: Senatori Bob Dole, Senatori Claiborne Pell, dhe kongresmenët: Eliot Engel, Tom Lantos, Ben Gilman, dhe shumë e shumë të tjerë.

I gjithë parku para Kongresit dhe Senatit Amerikan ishte i mbushur me flamuj kombëtarë dhe amerikan dhe parolla anti-jugosllave! Me flamujt kombëtarë shqiptarë edhe amerikan, dhe



2001 Cleveland / SHBA, takimi ne "Eagle" cafe me komunitetin shqiptarë

parollat e ndryshme anti-jugosllave e me bërtitjet "Dole, Dole", "USA, USA" impresionuam pa masë politikanët amerikan ne Washington DC. Nga të gjithë pjesëmarrësit, pjesë e të cilit tubim ishim edhe ne me shumë shokë dhe shqiptarë të tjerë që kishim udhëtuar me makina për 6 orë, orë të tëra nga Cleveland, Ohio sikurse shumica e shqiptarëve të tjerë që kishin ardhë nga secili cep i Amerikës. Po, vetëm për t'i çfaqë pakënaqësitë e tyre dhe të popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi, atje ku u mbledhëm dhe protestuam tërë ditën para Shtëpisë së Bardhë dhe Capitolit në kryeqytetin amerikan, në Washington DC..

\*\*\*

Me fillimin e luftës së Kosovës, të gjithë mediat botërore kishin kthyer interesin në ngjarjet më të reja në këtë pjesë të Ballkanit, sepse tani dihej se ç'pritej nga gjakëpirsat serb ndaj popullatës së pa mbrojtur shqiptare të cilët edhe më herët veçse e kishin treguar fytyrën e tyre të vërtetë të xhelatitit dhe të pa shpirtit. Po e kishin treguar me krimet e pa numërta që kishin bërë në Kroaci, ashtu edhe në Bosnjë e Hercegovinë.

Kjo ngjarje ishte si lajm kryesorë në mediat amerikane : CNN, ABC, NBC, CBS etj. Dominonin videot dhe fotografitë me dëbimet, maltretimet dhe vrasjet e njerëzve të pa fajshëm si dhe djegjet e pa mëshirëta të të gjitha vendbanimeve shqiptare, si dhe të gjendjes reale në Kosovë! Kulminacionin e të gjitha krimeve, kriminelët serb e arritën me krimet makabre të familjes Jashari në Skënderaj!

Kërcënimet e përditëshme të NATO'-s kundër Millosheviqit dhe forcave ushtarako-policore të Serbisë në Kosovë, dhe të gjitha anashkalimet që po shkëlmin ç'do konventë ndërkombëtare të njerëzimit mbi popullatën civile dhe të pa mbrojtur në Kososovë kishin filluar të bëhen bajate, sepse kishte vetëmse kërcënime e asgjë më tepër në praktikë. Siç po dukej presidentit serb Millosheviqit, tani çdo kërcënim që i vinte nga perëndimi, po i dukej veçesë hajgare, jo serioze, një gjë e cila po i iritonte pa masë forcat më të

mëdha botërore si: SHBA'në, Britaninë, Francën, Gjermaninë dhe të tjerët.

Tani më tepër se kurrë fillojnë lëvizjet në të gjithë botën shqiptare atje ku ishin me lobime dhe organizime sa më masovike, me demonstrata sa më të mëdha nëpër shumicën e kryeqendrave Europiane e në veçanti ato të qyteteve të Amerikës. Po, sidomos në qytetet ku ishte prezenca më e madhe e shqiptarëve. Shumë prej këtyre demonstratave në SHBA ishin organizuar dhe udhëhequr nga ish Kongresmeni Arbëresh Joe Dio Guardi nga "Liga Shqiptaro Amerikane", por kishte edhe organizime edhe prej shoqatave të ndryshme shqipëtare. Në demonstratën e 12 marsit të vitit 1998 në Washington DC, unë së bashku me shokët Hasan Bakija, Burhan Vneshta, Naime Hoxha, Aziz Ukshini, Ibrahim Vajushi dhe shumë e shumë të tjerë, udhëtua më se 6 orë me makinat tona për t'u bashkuar bashkëkombasve tanë dhe për të qenë pjesëmarrës të asaj demonstrate. Ishim shumë që u mblodhëm dhe shkua edhe ne nga Cleveland'i dhe rrethina. Ishim një kolonë e gjatë makinash për në Washington DC, për t'u bashkangjitur vëllezërve dhe motrave tona nga e gjithë Amerika për të shprehë pakënaqësitë tona për gjendjen e popullatës tonë që po dominonte në Kosovë. Në këtë demonstratë patëm përkrahje mjaftë të madhe edhe nga pjesëtarët e Kongresit dhe Senatit Amerikan. Në përkrahjen tonë shumë prej senatorëve dhe kongresmenëve dolën nga zyrat e tyre edhe na u bashkuar duke mbajtur edhe fjalime para të pranishmëve, të cilët ishin tërësisht fjalime pro- shqiptare dhe shumë anti-jugosllave! Patëm edhe demonstrata të më vonëshme edhe para OKB-së në Nju Jork, pastaj në Detroit, Çikago edhe në shumë qytete tjera të SHBA's.

Gjatë kësaj kohe me të madhe filloi edhe mbledhja e donacioneve për dërgim sa më të shpejtë të ndihmave popullatës kosovare, si dhe nga ana tjetër filloi edhe organizimi shumë i suksesshëm për mbledhjen e të hollave në fondin "Vendlindja Thërret" të Nju Jorkut. Ne nga Klivlendi meqenëse nuk mundëm të

organizojmë ndihmën në mënyrë të përgjithëshme, atëherë një grup i ynë vendosëm dhe organizuam në mënyrë individuale si: unë Ajaz Emiri, Muharrem Shaljani, Skender Demiri, Sejdi Emiri, Naime Hoxha dhe shumë të tjerë. Në mbledhjen e të hollave për donacione në ndihmë të UÇK's, përveçesë ndihmave në të holla, tani kishte filluar edhe organizimi për paraqitje të vullnetarëve nga komuniteti shqiptarë në të gjithë Amerikën për pjesëmarrje në Brigadën "Atlantiku". Kjo brigadë po përgaditej që së shpejtë të nisej dhe të shkojë për t'u bashkangjitur direkt në ndihmë luftës frontale, aradhave të UÇK-së në luftë kundër forcave paraushtarako-policore serbe. Për këtë formacion luftarak të Brigadës Atlantiku edhe unë isha mjaftë i interesuar për t'u bashkangjitur, një gjest i shqiptaro-amerikanëve i cili ngriti shumë lartë edhe moralin luftarak të UÇK-së në mbrojtjen dhe çlirimin e Kosovës!

Me fillimin e vitit 1999, forcat paramilitaro-ushtarake serbe shkakuan një mori krimesh mbi popullatën e pa mbrojtur shqiptare. Ndër krimet më të njohura që u bënë ishte më 15 Janar 1999 masakra e Reçakut, për të cilën përfaqësuesi i OSB Ambasadori William Walker i cili gjatë asaj kohe ndodhej në Kosovë, pas vizitës në vendin e ngjarjes, ai doli para të gjithë mediave botërore dhe e cilësoi ngjarjen e Reçakut si krim kundër njerëzimit. Nga kjo masakër u bë një kthesë e madhe edhe në aktivizimin e NATO's, tani më tepër po mendohej për pavarësimin e Kosovës nga fashistët gjakëpirës serb. Në këtë masakër, në mënyrën më brutale dhe më barbare u vranë mëse 45 shqipëtarë të pafajshëm të të gjitha moshave, nga dora e neofashistëve serb. Më vonë pasojnë edhe masakrat tjera të shumëta, si ajo e Krushës së Madhe dhe e Krushës së Vogël, ku u vranë edhe u dogjën mbi 221 banorë Shqipëtarë, 64 trupa prej të cilëve edhe sot ende nuk janë gjetur. Pas gjenocidit të Krushës kemi edhe atë të Izbicës, masakër e cila zë vend edhe në raportin e Departamentit të SHBA'së...

# Të mirë-informuar, por të çorientuar: Kriza e së vërtetës, është gjithmonë një krizë e shoqërisë

Pra demokracia e vërtetë bart një heroizëm të vetvete. Ajo ka nevojë për ata njerëz që guxojnë të thonë të vërtetën, pavarësisht të gjitha rreziqeve. Nga ana tjetër, e ashtuquajtura liri e mendimit, ka të bëjë vetëm me isegorinë. Vetëm liria e së vërtetës krijon një demokraci të vërtetë. Pa të, demokracia rrëshqet në një infokraci



**Nga Byung-CHUL HAN**

Vetëm informacioni nuk e shpjegon dot botën. Madje nga një këndvështrim kritik, ai i mjegullon botën. Ne i qasemi gjithmonë informacionit me dyshimin se gjërat mund të jenë ndryshe. Ai shoqërohet me një mosbesim themelor. Sa më shumë të përballemi me informacione të larmishme, aq më i fortë bëhet mosbesimi.

Në shoqërinë e informacionit, ne e humbasim besimin bazë: e jona është një shoqëri mosbesuese. Shoqëria e informacionit e përforcon përvojën e emergjencës. Informacionit i mungon qëndrueshmëria e qenies: "Kozmologjia e tij" është një kozmologji jo e qenies, por e rastësisë".

Informacioni është një koncept me dy fytyra, si fytyrat e Janusit. Ashtu si kjo Hyjni, edhe ai ka "një anë dashamirëse dhe një anë të frikshme". Dhe kjo çon drejt një "komunikimiparadoksal" sepse "riprodhon sigurinë dhe pasigurinë". Informacioni krijon një ambivalencëstrukturore bazë. Kështu Luhman thotë: "Modeli bazë i dykuptimisë merr formë të reja nga momenti në moment, por vetë ai mbetet e njëjtë. Ndoshta kjo nënkuptohet me termin "shoqëri informacioni"? Informacioni është në natyrën e tij një mbishitesë dhe kumulativ.

Megjithatë e vërteta, është narrative dhe ekskluzive. Ka shumë informacione apo mbetje informative. Ndërkohë e vërteta nuk përbën një grumbullim. Ajo

nuk është e shpeshtë. Në shumë mënyra është kundër informacionit. Eliminimi i rastësive dhe dykuptimisive; i ngritur në narrative, i jep kuptim dhe orientim.

Nga ana tjetër shoqëria e informacionit është e pakuptimtë. Transparente është vetëmbrazëtia. Sot jemi të mirë-informuar, por të çorientuar. Informacioni nuk ka fuqi udhëzuese. Edhe verifikimi më i vështirë i fakteve, nuk është në gjendje të vërtetojë të vërtetën, sepse kjo e tejkalon saktësinë ose korrektesinë e informacionit.

Tek e fundit e vërteta është një premtim, ashtu siç thuhet në Bibël: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta!". Edhe e vërteta diskursive në kuptimin e Habermasit ka një dimension teleologjik. Ajo është "premtimi për të arritur një kuptim të arsyeshëm të asaj që thuhet". Si një "proces argumentues", diskursi vendos për përmbajtjen e vërtetë të deklaratave.

Ideja e së vërtetës, matet në bazë të faktit nëse pretendimi mbi vlefshmërinë e pohimeve është i rimbursueshëm në një mënyrë diskursive. Kjo do të thotë që deklaratat duhet t'i rezistojnë kundër-argumenteve të mundshme dhe të gjejnë konsensusin e të gjithë pjesëmarrësve të mundshëm në bisedë.

E vërteta diskursive si mirëkuptim dhe konsensus e garanton kohezionin social. Ajo e stabilizon shoqërinë duke e reduktuar dykuptimisë. Kriza e së vërtetës është gjithmonë një krizë e

shoqërisë. Pa të vërtetën, shoqëria shpërbëhet nga brenda. Në atë rast, ajo mbahet e bashkuar vetëm nga marrëdhëniet e jashtme, instrumentale, ekonomike.

Për shembull recesionet e ndërsjella, që praktikohen kudo sot në botë, i korruptojnë marrëdhëniet njerëzore duke ia nënshtruar ato një komercializimi të plotë. Sot q'etë gjitha vlerat njerëzore sot ekonomizohen dhe komercializohen. Shoqëria dhe kultura janë duke u bërë vetë mallra.

Produkti zëvendëson të vërtetën. Vetëm informacioni apo të dhënat nuk e ndriçojnë botën. Thelbi i tyre është transparenca. Drita dhe errësira nuk janë veti të informacionit. Ato lindin në hapësirën narrative, ashtu si e mira dhe e keqja, apo e vërteta dhe gënjeshtria. E vërteta ka një karakter narrativ.

Prandaj, në shoqërinë e informacionit të de-narrativizuar ajo e humbet rrënjësisht kuptimin e saj. Fundi i rrëfimeve të mëdha, që sjellin post-modernitetin, përfundon në shoqërinë e informacionit. Narrativat degradojnë në informacion. Informacioni është kundër-figura e narratives.

Të dhënat e mëdha janë e kundërta e narratives së madhe. Të dhënat e mëdha nuk tregojnë. Në frëngjisht termi dixhital do të thotë numerik. Dhe numerike është narrative. E numërueshme dhe e ri-numërueshme i përkasin dy rrethet thelbësisht të ndryshme.

Teoritë e konspiracionit lulëzojnë veçanërisht në situata krizash. Sot

nuk jemi vetëm në një krizë ekonomike apo pandemike, por edhe në një krizë narrative. Rrëfimet krijojnë kuptim dhe identitet. Kështu, kriza narrative çon në boshllëkun e kuptimit, krizën e identitetit dhe çorientimin.

Dhe ky mikro-narrativat e teorive konspirative ofrojnë një lloj ilaçi. Ato supozohen si burime identiteti dhe kuptimi. Kjo është arsyeja pse ato u përhapën mbi të gjitha tek e djathta, ku është veçanërisht e theksuar nevoja për identitet. Teoritë e konspiracionit janë rezistente ndaj kontrollit të fakteve, pasi ato janë tregime që pavarësisht karakterit të tyre imagjinar, mbështesin perceptimin e realitetit.

Pra këto janë tregime faktike. Në to trillimi shndërrohet në fakt. Ajo që është vendimtare nuk është fakti, por koherenca narrative që e bën atë të besueshëm. Në teorinë e konspiracionit si rrëfim, zhduket rastësia. Në krizën e pandemisë, shifrat si "numri i rasteve të reja" apo "incidenca" e rrisin pasigurinë bazë, pasi nuk shpjegojnë asgjë.

Dhe vetëm numërimi zgjon nevojën për narrativa. Kjo është arsyeja pse kriza pandemike, është një terren pjellor për teori konspirative. Me shpjegimin e tyre total apo gënjeshtër të totale, ata e eliminojnë menjëherë pasigurinë. Demokracia nuk është në përputhje me nihilizmin e ri.

Ai presupozon të thënit të vërtetën. Vetëm infokracia mund të bëjë pa të vërtetën. Në leksionin e tij të fundit, pak para vdekjes së tij, Mishel Fuko iu përkushtua


"guximit për të thënë të vërtetën" (në greqishten e vjetër paresia), sikur të parashikonte krizën e afërt të së vërtetës, në të cilën humbet vullneti për të.

"Demokracia e vërtetë" udhëhiqet (Fuko i referohet historianit grek Polibi) nga dy parime, isegoria dhe paresia. Isegoria i referohet të drejtës që i jepet çdo qytetari për t'u shprehur lirisht. Paresia, thënia e të vërtetës presupozon isegorinë, por shkon përtej të drejtës kushtetuese për të folur.

Ajo i lejon disa individë të "thonë atë që mendojnë dhe atë që besojnë se është e vërtetë". Prandaj, paresia i detyron njerëzit që veprojnë politikisht, të thonë atë që është e vërtetë, të kujdesen për komunitetin, duke përdorur një "diskurs të arsyeshëm dhe të vërtetë".

Ata që flasin me guxim, pavarësisht gjithë rreziqet e përfshira, e praktikojnë paresinë. Paresia krijon bashkësinë. Ajo është thelbësore për demokracinë. Të thuash të vërtetën është një akt i vërtetë politik. Demokracia është e gjallë për sa kohë që praktikohet paresia. Paresia, ashtu si guximi për të thënë të vërtetën është akti politik kryesor.

Pra demokracia e vërtetë bart një heroizëm të vetvete. Ajo ka nevojë për ata njerëz që guxojnë të thonë të vërtetën, pavarësisht të gjitha rreziqeve. Nga ana tjetër, e ashtuquajtura liri e mendimit, ka të bëjë vetëm me isegorinë. Vetëm liria e së vërtetës krijon një demokraci të vërtetë. Pa të, demokracia rrëshqet në një infokraci. / "Linkiesta" – Bota.al



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## Kosova synon ta nisë me këmbë të mbarë kampanjën kualifikuese

Sonte (e shtunë) fillon rrugëtimi i “dardanëve” në kualifikueset për “Euro 2024”. Sulmuesit Vedat Muriqi dhe Albion Rrahmani kanë shprehur optimizëm se Kosova mund të marrë tri pikë nga ndeshja e parë kundër Izraelit. Në grupin e Kosovës bëjnë pjesë edhe Zvicra, Rumania, Bjellorusia dhe Andorra

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 24 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e shtunë) fillon kampanjën kualifikuese për Kampionatin Evropian “Euro 2024”. Të premten futbollistët “dardanë” kanë mbërritur në Tel Aviv. Sonte ata do të kërkojnë rezultat pozitiv kundër Izraelit në ndeshjen e parë të Grupit I, ku bëjnë pjesë edhe Zvicra, Bjellorusia, Rumania dhe Andorra.

Sulmuesi i Mallorcas, Vedat Muriqi, ka thënë se lojtarët e Kosovës janë në formë të mirë dhe kjo do të vërehet që në ndeshjen e parë. Ai ka thënë se “dardanët” në Izrael

kërkojnë fitore. “Shumica e lojtarëve janë që kanë shumë minutazh në ekipet e tyre dhe janë në formë të shkëlqyeshme, prandaj sigurisht se kjo do të vërehet që në ndeshjen e parë. Normalisht duhet edhe pak fat, por do të shkojmë në Izrael për fitore. Izraeli së bashku me Zvicrën janë rivalët më të fortë në grup dhe që parashikohet ta kalojnë grupin. Por, ne do të shkojmë atje ta bëjmë surprizën. Kur them surprizën e them në aspektin medial, ngaqë për ne, nëse fitojmë atje, nuk është surprizë sepse ne po shkojmë atje për fitore, pasi synojmë t’i fillojmë mbarë kualifikimet. Me këtë kualitet



që kemi besoj se do të arrijmë diçka që e kemi pritur për shumë vjet. Na ka marrë malli për tifozët tanë ‘Dardanët’, të cilët na përkrahin anembanë botës pa marrë parasysh se ku jemi. Dua që ata vetëm të kenë durim dhe të na përkrahin si gjithmonë”, ka thënë Muriqi.

Për herë të parë në Përfaqësuesë është ftuar sulmuesi i Ballkanit, Albion

Rrahmani, i cili është edhe lojtari i vetëm nga Superliga e Kosovës. Rrahmani ka thënë se Kosova ka një skuadër të mirë dhe në Izrael duhet të luftojnë për tri pikë. Ai ndihet i privilegjuar që është ftuar nga përzgjedhësi Giresse, derisa ka thënë se kjo ftesë është motiv për të punuar edhe më shumë në të ardhmen. “Është një ndjenjë e veçantë të jesh pjesë e

Përfaqësueses së Kosovës. Unë këtu jam lindur dhe rritur si futbollist. Shpresoj ta ndihmoj ekipin në objektivat e tij dhe të kualifikohemi në ‘Euro 2024’. Izraeli? Besoj në rezultat pozitiv, pasi kemi një grup shumë të mirë të lojtarëve dhe të gjithë janë në ecuri të mirë në klubet e tyre. Shpresoj ta dëshmojnë këtë edhe në ekipin përfaqësues dhe t’i arkëtojmë tri pikë atje. Përfaqësuesi i Superligës në Përfaqësuesë? Është privilegj. Zgjedhja e trajnerit Alain Giresse më ka dhënë motiv jashtëzakonisht shumë që të vazhdoj me gola në Superligë. Por, fillimisht shpresoj të nxjerrim rezultate pozitive me përfaqësuesen e pastaj të vazhdojmë përmbyshjen e objektivave me klubin”, ka deklaruar Rrahmani. Optimist kanë shprehur edhe përzgjedhësi Giresse dhe lojtarët e tjerë “dardanë”. Ndeshja në mes të Izraelit dhe Kosovës zhvillohet me fillim nga ora 18:00.



## Kosova rrëmben dy medalje të argjendta në Gjeorgji

Prishtinë, 24 mars (ER) - Kosova ka rrëmbyer dy medalje të argjendta në Grand Slamin e Tbilisit që po mbahet në Gjeorgji. Xhudistja Distria Krasniqi është stolitur me medaljen e argjendtë në Tbilisi, pasi në finale pësoi humbje nga xhudistja e

Uzbekistanit, Diyora Keldiyorova me IPPON. Derisa në gjysmëfinale, Distria arriti të triumfojë ndaj gjermanes Mascha Ballhaus. Ashtu si Distria, edhe Nora Gjakova ka fituar medaljen e argjendtë në këtë garë. Gjakova në finale është mposhtur nga serbja

Marica Perisiq për kategorinë deri në 57 kilogramë, kurse Flaka Loxha nuk ka arritur të shkojë më lart se raundi i tretë, duke e mbyllur garimin me një fitore dhe një humbje. Rezultatit më të dobët e pati Erza Muminoviq, e cila u eliminua në raundin e dytë.

## Sot superpërballja në mes të Vëllaznimit dhe Ponte Prizrenit

**PRISHTINË, 24 MARS** - Xhiroja e 27 e Prince Caffè Superligës do të sjellë super ndeshje në elitë. Ndeshje shumë interesante pritet të zhvillohet ndërmjet Vëllaznimit dhe Ponte Prizrenit. Të dyja skuadrat kanë nga tetë fitore dhe 18 humbje, duke grumbulluar nga 34 pikë dhe mund të jetë vendimtare, pasi deri në fund të garave të rregullta do të zhvillohet edhe një xhiro. Skuadrat renditen në pozitën 6, përkatësisht 7 dhe duan të jenë pjesë e “play-off”-it, kurse skuadra që përfundon në vendin e shtatë do të luajë me finalistin e Ligës së Parë në

“play-out” për një vend në elitë edicionin e ardhshëm. Të shtunë ndeshja e dytë është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Rahovecit, dy skuadrave “bardhekaltër”. Prishtinasit numërojnë 19 fitore e gjashtë humbje, kurse vreshtarët kanë katër fitore e 22 humbje. Përballje shumë interesante do të jetë ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Trepçës. Therandasit kanë 19 fitore e shtatë humbje, ndërsa mitrovicasit kanë 15 fitore e 11 humbje. Kjo është edhe një sfidë ndërmjet kampionit dhe nënkampionit aktual të Kosovës. Ndeshja e

fundit zhvillohet ndërmjet dy skuadrave me traditë, Pejës dhe Bashkimit. Pejanët kanë 19 fitore e shtatë humbje, kurse prizrenasit kanë siguruar pozitën e pestë me 11 fitore e 14 humbje.

### SUPERLIGA - JAVA 27

Të shtunë takohen:  
17:00 Vëllaznimi - Ponte Prizreni  
20:00 Sigal Prishtina - Rahoveci

Të dielën takohen:  
17:00 Golden Eagle Ylli - Trepça  
20:00 Peja - Bashkimi



## Tyson Fury mund të tërhiqet nga sporti

LONDËR, 24 MARS - Frank Warren, promotori i boksierit kampion bote në peshën e rëndë, Tyson Fury, ka thënë se britaniku mund të tërhiqet nga sporti, pasi nuk arriti ta finalizojë duelin e unifikimit të titujve kampionë bote ndaj Oleksandr Usk. Palët ishin në diskutime për ta zhvilluar këtë përballje më 29 prill në

“Wembley” (Londër), por marrëveshja dështoi. Nuk është ende e sigurt nëse Fury do të tërhiqet apo jo, por në rast se e bën këtë gjë, atëherë ai duhet ta dorëzojë titullin e kategorisë WBC. Kjo do t’u hapte rrugë boksierëve të tjerë të duelonin për këtë titull, përfshirë edhe Usykun. “Gjithçka është ende e paqartë

për momentin, madje Tyson Fury mund të dalë në pension. Nuk e di saktësisht se çfarë dëshiron të bëjë. Ai mund të bëjë gjithçka që dëshiron, është i lirë”, ka thënë Frank Warren për “Secondsout” në lidhje me të ardhmen e Tyson Furyt pas negociatave të dështuara me Oleksandr Usyk. “Tyson nuk e ka shumë

mendjen te paratë. Ai thjesht dëshiron të luftojë për katër titujt e peshës së rëndë, por stafi i Usykut u tërhoq nga bisedimet dhe Tysoni u mërzi”, ka deklaruar Warren. Fury, 34 vjeç, është i pamposhtur në ring (33 fitore e 1 barazim). Edhe vjet ai deklaroi se do të tërhiqej, por u rikthye sërish në ring.



## Gjasula: Në Poloni kënaqemi dhe me një pikë

TIRANË, 24 MARS - Klaus Gjasula, Mesfushori që aktivizohet në Bundesliga 2 me Darmstadt, në një konferencë për shtyp pak ditë para duelit ndaj Polonisë foli për tema të ndryshme dhe për strategun e ri, Sylvinho. “Gjendja fizike është në rregull. Luajta 20 minuta në ndeshjen e fundit, isha ok, por të shohim nëse do të jem në gjendje të luaj nga minuta e parë. Do të jap maksimumin nëse luaj. Dua t’i ndihmoj shokët. Aktivizimi në mbrojtje? Po, do të isha gati të luaja edhe në qendër të mbrojtjes. Jam mësuar me atë rol. E vendos trajneri, por jam gati të luaj në mbrojtje. Kemi një frymëmarrje të re. Trajneri ka shumë energji. Jemi optimistë që do të bëjmë mirë”, ka thënë Gjasula. “Sylvinho? Çdo trajner ka idetë e veta për të luajtur futboll. Kemi një skemë të re, të gjithë janë dakord dhe do ta japin maksimumin. Trajneri na është dukur shumë mirë në ditët e para.



Me emocion dhe energji, ka qenë shumë mirë deri tani. Sylvinho na ka treguar idetë e veta. Në të ardhmen do të bëhet më mirë”, ka shtuar Gjasula, i cili më pas ka bërë të qartë se kuqezinjtë do të jenë të kënaqur edhe me një pikë nga sfida ndaj polakëve. “Ne shkojmë në Poloni për ta kapur

maksimumin, por edhe një pikë është mirë. Në të dyja ndeshjet me Poloninë kanë treguar se mund të marrim pikë. Ata kanë kualitete të mira. Do të jemi shumë të përqendruar që të mos bëjmë gabime. Kjo është ajo që ka më shumë rëndësi”, ka deklaruar Gjasula.

## Fitojnë Orlando, Clevelandi, New Orleansi dhe Clippersat

ORLANDO, 24 MARS - Pa yjet e saj, skuadra e Brooklynit nuk arrin dot të fitojë, duke u mundur me rezultat 116-114 në shtëpi nga Clevelandi. Donovan Mitchell me 31 pikë e Evan Mobly me 26 pikë e 16 rebounde bënë dallimin për Cavaliersin, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Bridgesit për Netsin. Skuadra e Orlandos mposhti me rezultat 111-106 New Yorkun, ndeshje me rivalitet, ku për vendasit u dallua Paolo Banchero me 21 pikë. Fitojnë edhe Clippersat, që mundën me rezultat 127-105 Oklahoman, ndeshje ku dallimin e bëri Kawhi Leonard me 32 pikë. Skuadra e New Orleansit, falë një



“triple double” të Ingramit (30 pikë, 11 rebounde, 10 asistime), mundi me rezultat 115-90 Orlandon.

### REZULTATET

Orlando - New York	111-106
Brooklyn - Cleveland	114-116
New Orleans - Charlotte	115-96
Clippers - Oklahoma	127-105

### SHKURT

#### Mançini: Meritum një barazim

Trajneri i Italisë, Roberto Mançini, kërkon të shohë përpara. Anglia ishte, thjesht, pengesa e parë, më e forta. Trajneri italian nuk është i kënaqur që e nisën me humbje, por ka thënë se rruga është e gjatë. Sipas Mançinit, barazimi do të ishte rezultat real në këtë ndeshje. “E dinim se do të ishte një ndeshje e vështirë. Pësuam dy gola nga goditje standarde, por më pas, në pjesën e dytë, morëm kontrollin dhe dominuam, e meritonim të barazonim. Na vjen keq që e nisëm kështu, por rruga është ende e gjatë”, u shpreh Mançini duke bërë më pas edhe një koment për Retegium, një nga detajet pozitive të Italisë në këtë premierë: “Ka vetëm tri ditë me ne, ka nevojë të njihet me shokët dhe me futbollin italian. I duhet kohë”.

#### Southgate: Rëndësi kanë tri pikët që sollëm në shtëpi

Trajneri Gareth Southgate e ka shijuar fitoren e Anglisë ndaj Italisë në maksimum, pasi kjo ishte një ndeshje e veçantë edhe për të personalisht pasi siguroi fitoren e 50 në krye të Anglisë. “Treguam dy anët e medaljes, pjesën e parë kontrolluam mirë, ndërsa me fillimin e së dytës gabuam në shumë vendime. E rëndësishme është që luftuam, vuajtëm dhe sollëm në shtëpi tri pikë”, ka thënë Southgate.

#### Uniteti duhet të paguajë 170 milionë euro për Osimhenin

Manchester Unitedi duhet t’i paguajë 170 milionë euro për Victor Osimhenin e Napolit, sipas “Fichajes”. Nigeriani ka impresionuar me paraqitjet e tij për napolitanët me të cilët po korr suksese të mëdha në Serinë A dhe në Ligën e Kampioneve. Ai ka arritur t’i realizojë 25 gola në 29 paraqitje deri më tash për liderin italian. Ndërkaq, tekta napolitanët e kanë blerë 70 milionë euro, tani duan që të dalin 100 milionë euro fitim.

#### Kroos: Gara për titull nuk ka përfunduar, luftojmë deri në ndeshjen e fundit

Gara për titull në Spanjë po konsiderohet e mbyllur pas fitores që Barcelona e arriti në “El Clasico”, por mesfushori Toni Kroos ka thënë se Real Madridi nuk dorëzohet asnjëherë. “Për mua nuk ka përfunduar asgjë. Ne jemi Reali i Madridit dhe e kemi për detyrë të luftojmë deri në ndeshjen e fundit. Natyrisht që nuk jemi në pozitat më komode për të folur për titullin në La Liga, por jemi plotësisht në garë, përderisa matematika na mban në lojë. Të jeni të bindur se çfarëdo që të ndodhë Reali nuk do të dalë të bëjë dhurata. Ne do të bëjmë gjithçka për të fituar sa më shumë ndeshje. Pastaj kemi edhe të tjera gara të rëndësishme përpara në Kupë e në Ligën e Kampioneve, ndaj fitoret në La Liga shërbejnë për t’i përgatitur këto takime në mënyrë më të mirë”, ka thënë Kroosi.

## Iniesta: Barça s’ka blerë kurrë gjyqtarë

Ish-mesfushori i Barcelonës, Andres Iniesta, ka mbrojtur nderin e klubit katalanas pas përfshirjes në skandalin e pagesave për gjyqtarët. Iniesta, i

cili luajti për 14 sezone me klubin “blaugrana”, është shprehur i bindur gjatë një interviste për “RAC 1”, se Barça nuk ka blerë kurrë ndonjë

gjyqtar apo të ketë kërkuar favore prej tyre. “Jam plotësisht i bindur se Barça nuk ka blerë asnjëherë asnjë gjyqtar. Unë kurrë nuk kam parë apo dëgjuar

ndonjë gjë të çuditshme”, ka thënë ish-lojtari i Barçës në lidhje me polemikat për rastin “Negreira”. Iniesta ka vlerësuar dhe ecurinë e klubit në La Liga,

duke theksuar se vetëm ajo mund ta humbasë titullin në Spanjë. “E kanë gjithçka në dorën e tyre, por nuk duhet të relaksohen”, ka shtuar Iniesta.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Besartë Faik Thaqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Albana Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mirlinda Nuhaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 dhe diplomën certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Enis Buqinca nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Edona Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf "Selman Riza" nga kl. I-VIII në Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

